


ANALIZË

Raportimi i rasteve të korrupsionit të nivelet të lartë në sektorin shëndetësor në Shqipëri (2014-2024)



Ky publikim është përgatitur nga shoqata “Together for Life”, me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

Udhëheqëse e grupit të punës:

Eriselda Ndreca, Avokate & Koordinatore Projektesh

Ekspertë të raportit:

Ina Xhepa, Eksperte Ligjore

Erion Halili, Gazetar

Përmbajtja



Hyrje.....	5
Shkurtesat.....	6
Metodologjia.....	7
I. Kuptimi konceptual dhe ligjor i korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë dhe rëndësia e luftimit të tij.....	9
• <i>Kuptimi i gjerë (lato sensu) i korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>9</i>
• <i>Kuptimi i ngushtë (stricto sensu) i korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>12</i>
• <i>Elementët formalë të korrupsionit pasiv të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>13</i>
• <i>Elementët formalë të korrupsionit aktiv të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>13</i>
• <i>Dallimi i korrupsionit të thjeshtë me korrupsionin e nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>14</i>
• <i>Konkurrimi me veprën penale të shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera publikë.....</i>	<i>15</i>
II. Kuadri rregullator kombëtar dhe ndërkombëtar.....	17
• <i>Kuadri Ligjor dhe Institucional për luftën ndaj korrupsionit të nivelit të lartë plan ndërkombëtar.....</i>	<i>17</i>
• <i>Kuadri Ligjor Kombëtar në Shqipëri.....</i>	<i>18</i>
• <i>Instrumente të tjera ndërkombëtare me ndikim indirekt.....</i>	<i>20</i>
• <i>Rëndësia Strategjike e Luftimit të Korrupsionit të Nivelit të Lartë në Sektorin e Shëndetësisë.....</i>	<i>21</i>
III. Perceptimi i publikut për korrupsionin e nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....	23
• <i>Format më të përhapura të implikimit në korrupsion të funksioneve të larta shtetërore.....</i>	<i>24</i>



IV. Roli i medias si pushtet i katërt në raportimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi.....	25
• <i>Roli i medias në raportimin dhe informimin mbi rastet e korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>25</i>
V. Raste konkrete të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë në shqipëri.....	27
VI. Analizë e përgjithshme e rasteve të identifikuara.....	30
• <i>Trendi i korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi sipas vitit të ngjarjes.....</i>	<i>30</i>
• <i>Trendi i korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi sipas llojit të veprës penale.....</i>	<i>30</i>
• <i>Burimet e raportimit të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë.....</i>	<i>33</i>
• <i>Qasja e mediave dhe e raporteve ndaj parimit të prezumimit të pafajësisë së subjekteve të akuzuar për korrupsion të nivelit të lartë në shëndetësi.....</i>	<i>35</i>
VII. Analizë e veçantë e rasteve të identifikuara.....	37
• <i>Tenderi për barnat e sëmundjeve tumorale (2015).....</i>	<i>38</i>
• <i>Tenderi për rojën private në QSUT (2016).....</i>	<i>39</i>
• <i>Tenderi për implante ortopedike, 2 milionë euro (2016-2021).....</i>	<i>39</i>
• <i>Koncesioni i Check-Up (2015–2020).....</i>	<i>40</i>
• <i>Rasti i barnave të skaduara dhe recetave fiktive – FSDKSH (2014-2016).....</i>	<i>41</i>
• <i>Koncesioni i laboratorëve mjekësorë (2020-2022).....</i>	<i>43</i>
• <i>Tenderi për respiratorët gjatë pandemisë COVID-19 (2022).....</i>	<i>43</i>
• <i>Koncesionet e Sterilizimit dhe Dializës (2015-2023).....</i>	<i>44</i>
• <i>Tenderi i supervizimit të qendrave shëndetësore në Tiranë dhe Durrës (2023).....</i>	<i>47</i>
VIII. Dëmet efektive dhe eventuale në sistemin e shëndetësisë si rezultat i korrupsionit të nivelit të lartë.....	49
IX. Konkluzione dhe rekomandime.....	51
X. Bibliografi dhe Referenca.....	55
• A. Referenca mediatike.....	55
• B. Referenca nga Raporte.....	55
• C. Referenca ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.....	56
• D. Doktrinë.....	56
• E. Jurisprudencë Kombëtare.....	56
• F. Jurisprudencë Ndërkombëtare.....	56

Hyrje



Ky studim ka si objekt kryesor zhvillimin e një analizë sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të ndërdisiplinuar të rasteve të korrupsionit të nivelit në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri, të identifikuara gjatë dekadës së fundit. Në terma më konkretë kohorë, studimi përfshin rastet e korrupsionit të nivelit të lartë të identifikuara nga data 1 Janar 2014 - 31 Dhjetor 2024. Përzgjedhja e kësaj periudhe kohore nuk lidhet me qeverisjen e vendit nga forca të caktuara politike të cilat mund të kenë qenë në pushtet. Periudha 10 vjeçare është marrë si periudhë referencë për lehtësi të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për rastet.

Qëllimi është të dokumentohen modus operandi të gjitha veprimet dhe praktikatat korruptive të identifikuara nga burime mediatike, kryesisht me natyrë investiguese, raporte të institucioneve të pavarura me kompetenca kontrolluese, audituese dhe mbikëqyrëse, apo raporte nga institucione të tjera, hapësirat ligjore që i kanë mundësuar ato dhe përgjigja institucionale në ndjekjen dhe luftimin e korrupsionit, roli i medias në informimin e publikut së bashku me modalitetet e mënyrës së tejçimit dhe qartësisë së informacionit, si dhe investigimit a-priori dhe hapave konkretë të ndërmarra në kuadër të luftës kundër korrupsionit në sektorin e shëndetësisë, perceptimin e publikut mbi korrupsionin në shëndetësi, si dhe vlerësimi i pasojave negative të shkaktuara mbi funksionimin normal të sistemit shëndetësor, aksesin në kujdesin shëndetësor dhe besimin publik ndaj institucioneve shtetërore.

Nëpërmjet një analize të thelluar dhe krahasimore të rasteve të dokumentuara, synohet të nxirren konkluzione të mbështetura në fakte empirike dhe analiza të thelluara sociale dhe ligjore, të cilat mund të sugjerojnë hartimin e politikave publike, forcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit dhe rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe hetimore të institucioneve përgjegjëse.

Shkurtesat



APP	Agjencia e Prokurimit Publik
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
GRECO	Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit
GjAKKO	Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GjKKO	Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
GjEDNj	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PPP	Partneriteti Publik-Privat
SPAK	Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
TFL	Shoqata “Together for Life”
UNCAC	Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit

METODOLOGJIA



Metoda e kërkimit në burime të hapura (Open Source Research) - Kjo metodë është përdorur për identifikimin fillestar të rasteve përmes analizës së burimeve të hapura, publike dhe të aksesueshme nga kushdo. Në përputhje me metodologjinë, kërkimi është orientuar drejt burimeve mediatike të besueshme si Top Channel, ABC News, BIRN, Euronews Albania, Exit.al, si dhe media të tjera të shkruara të cilat për nga pikëpamja teknike e web faqeve që zotërojnë identifikohen si secured (https), etj., si dhe dokumenteve të institucioneve zyrtare (KLSH, ILDKPKI, SPAK, Komisioni i Prokurimit Publik). Përzgjedhja e rasteve është bërë në bazë të fjalëve kyçe të lidhura me korrupsionin e zyrtarëve dhe funksionarëve të lartë në shëndetësi për periudhën kohore 2014–2024.

Metoda juridiko-institucionale - Kjo metodë fokusohet në analizën ligjore dhe institucionale të secilit rast të përzgjedhur, për të vlerësuar shkallën e zbatimit ose shkëlqes së dispozitave të Kodit Penal, ligjit për prokurimet publike, ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesit” dhe ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodit Penal, etj. Është analizuar roli i institucioneve të ndjekjes penale (SPAK, prokurori, gjykatat e posaçme) dhe efektiviteti i sanksioneve në rastet kur janë marrë vendime përfundimtare.

Metoda e analizës krahasuese mbi të dhënat sekondare - Kjo metodë është përdorur për të gjeneruar të dhëna krahasuese ndërmjet rasteve. Analiza sasiore përfshin vlerësimin e shpërndarjes së rasteve sipas viteve, institucioneve të përfshira dhe fazave procedurale. Në anën tjetër, analiza cilësore përqendrohet në identifikimin e modeleve të përsëritura të korrupsionit, formave sistematike të abuzimit me procedurat e prokurimit, përfshirjes së aktorëve të njëjtë në raste të ndryshme, dhe boshllëqeve që lejojnë korrupsionin institucional.

Metoda e triangulimit - Për çdo rast është kryer kryqëzim i informacionit ndërmjet burimeve të ndryshme si media dhe raporte zyrtare të aksesueshme nga publiku, dhe të dhëna të dorëzuara nga institucionet me kërkesë zyrtare. Kjo metodë ka shërbyer për të verifikuar faktet, për të përjashtuar raportimet spekulative dhe për të ndarë të dhënat e konfirmuara nga akuzat e paprovuara.



Nëpërmjet shkresës¹ drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë përKorrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Together for Life ka kërkuar që për 9 rastet e seleksionuara të informohet mbi faktin e regjistrimit të çështjes penale në gjykatë, identitetin e subjektit në ngarkim të të cilit po kryhet gjykimi, faza konkrete e gjykimit si dhe vënien në dispozicion të dispozitivit të vendimit të gjykatës në rast se është marrë. Gjithashtu nëpërmjet shkresës² drejtuar Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Together for Life ka kërkuar që për të 9 rastet e seleksionuara, të informohet mbi: faktin e regjistrimit të çështjes penale në gjykatën e apelit, fazën konkrete të gjykimit si dhe vënien në dispozicion të dispozitivit të vendimittë gjykatës në rast se është marrë.

Metoda e analizës së ndikimit institucional dhe publik - Përmes kësaj metode është vlerësuar ndikimi i rasteve të korrupsionit në performancën e institucioneve shëndetësore dhe në perceptimin qytetar. Analiza detajon rrezikun e pasojave në cilësinë e shërbimeve të ofruara, shpërndarjen e burimeve, aksesueshmëria në kujdesin shëndetësor, si dhe pasojat në mortalitet/morbiditet për sëmundje të parandalueshme.

Metodologjia e analizës kuantitative përmes analizës statistikore të të dhënave të strukturuar - Ky studim ka përdorur një qasje të kombinuar metodologjike, duke mbledhur të dhëna në funksion të objektivave kërkimore të përcaktuara. Të dhënat e mbledhura janë sistemuar dhe përpunuar përmes teknikave elektronike që mundësojnë renditjen, filtrimin dhe analizën krahasuese të informacionit. Specifikisht, është përdorur platforma Google Forms për të strukturuar dhe klasifikuar automatikisht të dhënat sipas kritereve të parapërcaktuara, ndërsa të dhënat janë transferuar dhe përpunuar më tej në format Excel, për qëllime të analizës statistikore dhe vizualizimit analitik.

^[1] Shkresa Nr. 8/2025 Prot. datë 04.06.2025.

^[2] Shkresa Nr. 6/2025 Prot. datë 04.06.2025.

Kuptimi konceptual dhe ligjor i korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë dhe rëndësia e luftimit të tij



- **Kuptimi i gjerë (lato sensu) i korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë**

Korrupsioni është mjaft evident thuajse në të gjitha fushat e jetës dhe përbën një fenomen i cili minon në mënyrë thelbësore mirefunksionimin e shtetit të së drejtës dhe parimet e një shteti demokratik. Sa i takon definicioneve ekzakte të korrupsionit, jepen disa përkufizime dhe identifikohen disa forma të cilat janë më të zakonshme se të tjerat, për të cilin jepen kuptime të ndryshme nga aktorë të ndryshëm institucionale, organizma ndërkombëtarë, apo edhe nga publiku i gjerë. Për të kuptuar se cilat raste të korrupsionit bëjnë pjesë në veprat penale të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, duhen studiuar dhe kuptuar të gjitha dimensionet dhe cilësimet e korrupsionit.

Sakaq, sipas Transparency International, korrupsioni është një kërcënim global në zhvillim, që bën shumë më tepër sesa të minojë zhvillimin – ai është një ndër shkaqet kryesore të rënies së demokracisë, paqëndrueshmërisë dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Komuniteti ndërkombëtar dhe çdo shtet duhet ta trajtojë luftën kundër korrupsionit si një përparësi madhore dhe afatgjatë. Kjo është thelbësore për të frenuar autoritarizmin dhe për të garantuar një botë paqësore, të lirë dhe të qëndrueshme.³

Ndërkohë, sa i takon korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, theksojmë se në planin ndërkombëtar e gjejmë të cilësuar me termin “Korrupsioni i madh” dhe sipas Transparency International, korrupsioni i madh është abuzimi i pushtetit të nivelit të lartë që u sjell dobi pak vetave në kurriz të shumicës. Zakonisht ka tri karakteristika kryesore të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për t’u konsideruar si i tillë. Konkretisht, duhet të ekzistojë një plan veprimi sistematik ose i organizuar mirë, që përfshin zyrtarë publikë të nivelit të lartë si dhe dëmet serioze të shkaktuara, siç janë shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut.⁴

^[3] François Valérian Chair of Transparency International

^[4] <https://www.transparency.org/en/our-priorities/grand-corruption>



Të njëjtin standard të përkufizimit ka mbajtur edhe United Nations Development Programme (UNDP), e cila përcakton se kemi korrupsion të niveleve të larta, veçanërisht në nivelin e hartimit të politikave.⁵ Përshkrimet e mësipërme dhe cilësimet e formave të ndryshme të shfaqjes së korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin shëndetësor, vijnë si rezultat i praktikave korruptive të identifikuara më parë por edhe mënyrës se si e percepton publiku i thjeshtë.

Ndërkohë, po t'i referohemi mënyrës së përkufizimit të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, mund të themi se edhe në plan kombëtar nuk ka një përkufizim të konsoliduar pasi jo gjithmonë i qëndrojnë strikt ligjit penal për përkufizimin e tij. Sakaq, Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit, në fjalorin antikorrupsion të publikuar në vitin 2022, përcakton se korrupsioni në sektorin e shëndetësisë shfaqet në shumë forma në fusha të ndryshme, të tilla si: ndërtimi i objekteve shëndetësore, blerja e pajisjeve dhe furnizimeve, shpërndarja dhe përdorimi i produkteve farmaceutike, arsimimi i punonjësve të sektorit përkatës, falsifikimi i hulumtimeve mjekësore, dhe, ndoshta më e rëndësishmja për këtë raport, ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor.⁶

Ndërsa, sa i takon konceptit të korrupsionit të madh, të dhënë në të njëjtin fjalor, kemi të bëjmë me përfshirjen e zyrtarëve qeveritarë të nivelit më të lartë dhe zyrtarë të zgjedhur që marrin vendime dhe alokojnë burime të rëndësishme, që shfrytëzojnë mundësitë që paraqiten përmes punës së qeverisë. Në këtë rast, administratorët e lartë dhe politikanët përdorin detyrën e tyre për të bërë përfitime të mëdha personale, politike ose korporative. Ky lloj korrupsioni përfshin funksionimin e mekanizmave më kompleksë dhe më të mirë ku ndërmjetësit luajnë një rol kyç. Duke qenë se abuzimet dhe përfitimet e marra, si dhe efektet sociale dhe ekonomike janë në numër të madh, nuk ka një kufi të qartë ndërmjet formës aktive dhe pasive të tij.⁷

• Kuptimi i ngushtë (stricto sensu) i korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë

Ndërkohë, po t'i referohemi në mënyrë strikte legjislacionit penal dhe atij procedural penal shqiptar, mund të themi se përcaktohen qartësisht kufijtë e cilësimit juridik të veprimeve të caktuara si akte korruptive.

^[5] <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/publications/Anticorruption%20Methods%20and%20Tools%20in%20Health%20Lo%20Res%20final.pdf>

^[6] Faqe 16-17

https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Fjalori_Antikorrupsion_AL.pdf

^[7] Po aty. Faqe 27.



Më konkretisht, figurat aktive dhe pasive të korrupsionit të nivelit të lartë përcaktohen respektivisht nga neni 245 (Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë), dhe Neni 260 (Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë) i Kodit Penal. Përveç kësaj, është me rëndësi interpretimi i normave juridike në korrelacion me njëra-tjetrën.

Sakaq, po t'i referohemi parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht nenit 75/a të tij, vërejmë që përveç renditjes së veprave penale që hyjnë në kompetencën lëndore të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në pikën c të tij përcaktohet se akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, janë gjithashtu kompetencë lëndore dhe funksionale e SPAK dhe e Gjykatave të Posaçme.

Në interpretim të kësaj të fundit, arrihet në përfundimin se të gjitha veprat e penale të korrupsionit në sektorin shëndetësor, të cilat implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë subjektet e sipërcituara, do të konsiderohen korrupsion i nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë. Për të pasur një kornizë më të qartë se kush do të konsiderohet funksionar i lartë, për efekt të identifikimit të veprave penale të sipërcituara, vlen të merren në konsideratë Ligji Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”.

Në interpretim literal të këtyre normave, del se në rrethin e funksionarëve të lartë shtetërorë, ku përfshihen dy kategori të personave: së pari, bëjnë pjesë funksionarët politikë dhe në mënyrë të veçantë, Kryeministri, deputetët, Ministrat, stafet politike të tyre (këshilltarë dhe drejtues kabinetit), drejtuesit e institucioneve qendrore të emëruar nga Kuvendi apo Këshilli Ministrave;^[8] dhe së dyti, bëjnë pjesë pozicioni i sekretarit të përgjithshëm, drejtorit të departamentit; drejtorëve të drejtorive të përgjithshme si dhe pozicionet e barasvlershme me tri të parat.^[9] Ndërkohë, në rrethin e të zgjedhurve vendorë cilësohen kryetarët e bashkive dhe anëtarët e këshillave bashkiake të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga populli.^[10]

^[8] Ligj nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

^[9] Neni 19 pika 4 e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

^[10] Ligji Nr.10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.”



- **Elementët formalë të korrupsionit pasiv të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë**

Për të konsideruar se një akt korruptiv është kryer dhe vepra penale është konsumuar, duhet që të vërtetohet fakti i cenimit të objektit të veprës penale, domethënë që të vërtetohet cenimi i një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar autoritetin dhe funksionimin e rregullt dhe të paanshëm të administratës publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizikë apo juridikë të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal. Në kontekst të objektit të analizës, në rastin konkret duhet të vërtetohet që është cenuar një aspekt i sistemit shëndetësor në Shqipëri, ku përveç cenimit të kësaj marrëdhënie të vendosur nga shteti, cenohen edhe interesat e ligjshëm të përfituesve të shërbimeve shëndetësore.

Objekti i mbrojtjes së marrëdhënies juridike nga norma penale është mbrojtja dhe ruajtja e ushtrimit të ligjshëm të funksioneve publike në sistemin shëndetësor Shqiptar, si dhe ruajtja e besimit që individët kanë tek funksionarët që ushtrojnë detyra publike në këtë sektor në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe besnikërisë së ushtrimit të detyrës publike, duke i shërbyer me përpikëri vetëm interesave publikë, në mënyrë të paanshme dhe objektive.

Në lidhje me anën objektive (actus rea) të figurës së veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”. Në kuptim të nenit 260 të Kodit Penal, nga ana objektive kjo vepër penale kryhet me veprime aktive të shprehura në mënyra të ndryshme, me anë të kërkimit ose marrjes, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çfarëdo përfitimi të parregullt nga ana e funksionarëve të lartë shtetëror apo e të zgjedhurve vendorë apo/ose pranimi të një oferte a premtimi, për vete ose për persona të tjerë, me qëllimin për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tyre. “Kërkimi” i referohet një veprimi të njëanshëm të kryer nga një prej subjekteve të lartpërmendura, i cili në mendjen e një personi tjetër i jep të kuptojë në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar se ai duhet të paguajë për veprimin e kërkuar. Ndërkohë, “Marrja” është pranimi i një përfitimi të parregullt drejtpërdrejt nga ana e funksionarëve publik ose nga një ndërmjetës që mund të jetë i afërm, familjar etj.¹¹

^[11] Neni 260: “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.”



Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale, ose në terma më konkretë me qëndrimin psikik që subjektet e sipërcituara kanë ndaj korrupsionit, mund të themi që si rregull kjo vepër penale kërkon si formë faji dashjen direkte. Në terma juridikë, kjo formë faji nënkupton që një funksionar i lartë shtetëror parashikon pasojat e kundërligjshme të veprimeve të tij të cilat mund t'i kundërdrejtohen sistemit shëndetësor apo publikut, e megjithatë dëshiron ardhjen e tyre.¹² Për konsumimin e veprës penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë detyra publike, mund të merret apo pranohet përfitim nëse funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhur vendor është i ndërgjegjshëm që subjekti tjetër jep ose ofron një përfitim të parregullt.¹³ Kjo vlen të theksohet pasi në jo pak raste mund të konfondohej me premtimet e hapura që mund të bëhen nga subjekte të caktuara, por është e domosdoshme që ky premtim t'i jetë kundërdrejtuar njërit prej funksionarëve, dhe ky i fundit të ketë marrë dijeni dhe njëkohësisht ta ketë pranuar atë pavarësisht faktit nëse e ka shtënë në dorë ose jo.¹⁴

Një premtim i thjeshtë për përfitime në të ardhmen, pa iu drejtuar konkretisht funksionarit dhe pa u pranuar nga ana e tij, duke u ndërgjegjësuar dhe pasur dijeninë rreth saj, nuk do të mjaftonte për konfigurimin e kësaj vepre penale. Prandaj premtimi duhet të jepet në mënyrë të atillë që jetë i konkretizuar dhe të lejojë ndërgjegjësimin dhe njohjen e tij nga ana e funksionarit të lartë, në mënyrë që të mundësojë mbajtjen e tij.¹⁵ Qëllimi, pra kërkimi ose marrja e çfarëdo përfitimi të parregullt ose pranimi i një oferte të parregullt, është element i domosdoshëm i figurës së kësaj vepre penale.¹⁶

• **Elementët formalë të korrupsionit aktiv të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë**

Kur flasim për formën aktive të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, i referohemi specifikisht nenit 245 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”.¹⁷ Në përmbushje të frymës dhe qëllimit të legjislacionit penal, parashikimi i kësaj vepre penale ka për objekt mbrojtjen e posaçme të marrëdhënies juridike të vendosur nga shteti për të siguruar funksionimin normal dhe autoritetin e institucioneve shtetërore, si dhe interesat e ligjshëm të personave fizikë apo juridikë.

^[12] Neni 15 i Kodit Penal.

^[13] Kemi të bëjmë me përfitim të parregullt kur përfitimi nuk është i ligjshëm dhe i detyrueshëm dhe kur funksionari nuk ka as të drejtën, as tagrin, as detyrimin për ta marrë atë.

^[14] Trajnim vazhdues Shkolla e Magjistratures, Dhimitër Lara & Sotir Kllapi, “Korrupsioni aktiv dhe pasiv i funksionarëve publikë dhe në sektorin privat” 02-03 Mars 2023.

^[15] Vendimi Nr. 216, datë 16.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

^[16] Vendimi Nr. 484, datë 19.05.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

^[17] Neni 245 i Kodit Penal: “Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, funksionarëve të lartë shtetërorë ose të të zgjedhurve vendorë, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e funksionit të tij, dënohen me burgim nga një deri në pesë vjet.”



Cenimi i kësaj marrëdhënie juridike apo interesi, përbën veprë penale dhe e ngarkon subjektin me përgjegjësi penale. Ndërkohë, ana objektive (actus rea) e kësaj veprë penale konfigurohet përmes premtimit, propozimit ose dhënies, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë, për të kryer ose moskryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij.

Pra, ashtu si në rastin e korrupsionit pasiv, edhe forma aktive e veprës penale kryhet përmes veprimeve aktive të kundërligjshme dhe në themel qëndron një shkëmbim i kundërligjshëm dhe i ndërsjellët. Edhe në këtë rast, definicioni i përfitimit të parregullt lidhet me faktin se ai është i ligjshëm dhe i detyrueshëm sipas normave të së drejtës dhe se funksionarët e lartë shtetëror nuk kanë as të drejtën, as tagrin, as detyrimin për ta marrë atë. Në këtë rast, ana subjektive konsumohet gjithashtu me dashje direkte ndërsa subjekti i veprës penale, ndryshe nga figura e korrupsionit pasiv, subjekti është i përgjithshëm. Pra, kushdo që mund të vendoset në rolin e ofruesit, dhënësit, premtuesit të përfitimit të parregullt kundrejt një funksionari të lartë shtetëror apo i një të zgjedhuri vendor.

• **Dallimi i korrupsionit të thjeshtë me korrupsionin e nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë**

Sa i takon elementëve të veprës penale të korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe të zgjedhurve vendorë në sektorin e shëndetësisë, në dallim nga Korrupsioni i thjeshtë, mund të themi se kemi një formë korrupsioni më të rëndë për nga pasojat që i shkakton objektit të marrëdhënies juridike që cenon dhe për nga masa e dënimit penal që parashikohet nga legjislacioni penal.

Në identifikim të objektit të marrëdhënies juridike, dy llojet e korrupsionit gjenden të sanksionuara në të njëjtin kapitull të veprave penale sipas parashikimit që bëhet nga Kodi Penal në pjesën e posaçme të tij. Përkatësisht, bëjnë pjesë në grupin e veprave penale kundër autoritetit të shtetit. Në mënyrë të veçantë, me vepra penale kundër autoritetit të shtetit kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) shoqërisht të rrezikshme të kundërligjshme që drejtohen kundër veprimtarisë normale shtetërore, të funksionit publik dhe sigurisë publike, sekretit dhe kufijve shtetërore, si dhe marrëdhënieve të ndërsjella të tyre me shtetasit, të kryera me faj.¹⁸

^[18] Ismet Elezi, “E drejta penale, pjesa e posaçme”, 2016.



Sa i takon formave të veprimeve (anës objektive), nga vetë përshkrimi i veprave penale, del se ato janë identike. Madje, për t'u konsideruar se kemi një korrupsion të niveli të lartë në shëndetësi, duhet që *premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt*, të jetë kryer në sektorin e shëndetësisë. Në të njëjtën linjë qëndron edhe elementi i fajit (ana subjektive), në kryerjen e secilës prej veprave penale. Konkretisht, të dyja format kryhen me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi material ose jopasuror. Elementi kryesor që qëndron edhe në themel të dallimit të të dy dispozitave, është subjekti që është njëkohësisht edhe autori i veprës penale. Në rastin e veprës penale të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror dhe i të zgjedhurve vendor, subjekti është i posaçëm dhe përcaktohet që në titullin e veprës penale. Ndërkohë, veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike mund të kryejë çdo subjekt që kryen një funksion publik të caktuar.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, rezervon një marzh dënimi me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet për veprën penale të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë. Ndërsa, vepra penale e korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Në krahasim me sa më sipër, të njëjtat vepra penale të korrupsionit të kryera nga shtetas të cilët nuk ushtrojnë funksione publike, janë më pak të dënueshme se ato të kryera nga funksionarët shtetërorë.

• Konkurrimi me veprën penale të shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera publike

Në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri, procedurat e prokurimeve publike janë shpesh objekt i shkeljeve të procedurave ligjore, ku veprat penale të shkeljes së barazisë në tendera¹⁹ dhe ato të korrupsionit aktiv/pasiv shfaqen shpesh në formë të ndërlidhur. Më konkretisht,²⁰ duhet theksuar se vepra penale e shkeljes së barazisë në tendera dhe ankande konkurron edhe me veprën penale të korrupsionit pasiv të zyrtarëve publikë (neni 260 i Kodit Penal), përderisa interesi privat i marrjes së përfitimit të parregullt për vetë apo për të tjerë lidhet me kryerjen apo moskryerjen e një veprimi që lidhet me funksionin e tij.²¹ Në praktikën gjyqësore shqiptare janë evidentuar raste ku zyrtarë të lartë publikë kanë favorizuar kompani private në tenderë të rëndësishëm, në këmbim të përfitimeve financiare.

^[19] Neni 258 i Kodit Penal: “Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”

^[20] Phd (cand.) Fjorida Ballauri (Kallço), “Konflikti i interesit dhe veprat penale në fushën e prokurimeve publike”, JUS & JUSTICIA / NR.9 / VJESHTË 2014.

^[21] <https://uet.edu.al/jus-justicia/wp-content/uploads/2023/01/Konflikti-i-interesit-dhe-veprat-penale-ne-fushen-e-prokurimeve-publike.pdf>



Ndërsa, në rastin e “konkurrimit të veprave penale” kemi të bëjmë me më shumë se një marrëdhënie juridike të mbrojtur penalisht, dhe që në rast shkeljeje, shtrohet problemi për të vërtetuar nëse janë cenuar të gjitha këto marrëdhënie juridike, qoftë për shkak të ‘një’ veprimi apo mosveprimi të vetëm kriminal (konkurrim formal), apo qoftë për shkak të një ‘pluraliteti’ veprimesh apo mosveprimesh (konkurrim material). Pra, në këtë rast ngrihet çështja nëse subjekti aktiv i veprës penale, domethënë autori i saj, do të ndëshkohet për të gjitha cenimet që ai i ka shkaktuar marrëdhënieve juridike të mbrojtura nga ligji penal apo jo.²²

Ky konkurrim penal nxjerr në pah një formë të strukturuar dhe sistemike të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë, që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve dhe në besimin e publikut ndaj institucioneve shtetërore. Për këtë arsye, analizat gjyqësore dhe administrative rekomandojnë masa të forta për rritjen e transparencës në tenderë, forcimin e monitorimit institucional dhe hetimin proaktiv të zyrtarëve të lartë për çdo shkelje që cenon barazinë e pjesëmarrësve dhe integritetin publik.

^[22] Vendim Nr. 3 datë 02.11.2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. (paragrafi 24)

II. KUADRI RREGULLATOR KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR



- **Kuadri Ligjor dhe Institucional për luftën ndaj korrupsionit të nivelit të lartë plan-ndërkombëtar**

Kuadri ligjor dhe institucional ndërkombëtar për luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë përbëhet nga një sërë instrumentesh dhe mekanizmash të cilët përcaktojnë standarde të detyrueshme apo rekomanduese për shtetet, me qëllim parandalimin, zbulimin dhe ndëshkimin e këtij fenomeni.

Një nga instrumentet më të rëndësishëm në këtë fushë është Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), e miratuar në vitin 2003 dhe ratifikuar nga Shqipëria me ligjin e vitit 2006.²³ Kjo konventë përfaqëson dokumentin më gjithëpërfshirës ligjor në luftën kundër korrupsionit, duke detyruar shtetet palë të inkriminojnë një sërë veprash penale që lidhen me korrupsionin, përfshirë ryshfetin, shpërdorimin e funksionit publik dhe pasurimin e paligjshëm të zyrtarëve të lartë. Në thelb, konventa shtrin ndikimin e saj në të gjitha fazat e ciklit antikorrupsion: nga parandalimi dhe ndërgjegjësimi publik, te hetimi penal dhe konfiskimi i pasurive të paligjshme.

UNCAC i kushton një vëmendje të veçantë masave parandaluese, duke theksuar nevojën për integritet, transparencë dhe meritokraci në sektorin publik.²⁴ Po ashtu, ajo kërkon zbatimin e praktikave të ndershme dhe transparente në prokurimet publike²⁵, duke synuar të minimizojë hapësirat për ndërhyrje dhe manipulim nga zyrtarë të lartë. Një aspekt thelbësor i konventës është edhe mbështetja dhe mbrojtja ligjore e sinjalizuesve të korrupsionit²⁶, duke e konsideruar rolin e tyre si thelbësor në zbulimin e praktikave të dëmshme në nivelet më të larta të pushtetit. Gjithashtu, konventa promovon ngritjen dhe fuqizimin e mekanizmave të mbikëqyrjes së pavarur, përfshirë auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, si garanci për integritetin institucional.

^[23] Ligji nr. 9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit.”

^[24] Neni 7.

^[25] Neni 9 i UNCAC.

^[26] Neni 33 i UNCAC.



Përveç Konventës së OKB-së, një rol të rëndësishëm në zhvillimin e standardeve antikorrupsion luan edhe Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), një mekanizëm i Këshillit të Evropës që monitoron përmbushjen e angazhimeve të shteteve në luftën kundër korrupsionit. Përmes raporteve të saj periodike, GRECO i ka rekomanduar Shqipërisë forcimin e integritetit institucional dhe rritjen e transparencës në menaxhimin e fondeve publike, si dhe miratimin dhe zbatimin efektiv të politikave parandaluese në sektorët më të ndjeshëm, përfshirë sektorin e shëndetësisë. GRECO thekson gjithashtu rëndësinë e realizimit të vlerësimeve të rrezikut për korrupsion dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale për hetimin dhe ndëshkimin e rasteve që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë.

Konventa Penale për Korrupsionin e Këshillit të Evropës, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2001,²⁷ përbën një instrument ndërkombëtar thelbësor në luftën kundër korrupsionit, përfshirë edhe atë të nivelit të lartë. Edhe pse konventa nuk e përdor shprehimisht termin “korrupsion i nivelit të lartë”, ajo parashikon kriminalizimin e formave të ndryshme të korrupsionit aktiv dhe pasiv në sektorin publik dhe privat, duke përfshirë edhe funksionarët publikë të rangut të lartë. Dispozitat e saj janë të zbatueshme ndaj çdo zyrtari publik, pa bërë dallim hierarkik, çka e bën këtë instrument të aplikueshëm edhe në rastet që përfshijnë zyrtarë të ministrive, drejtues institucionesh qendrore apo funksionarë të lartë në sektorin e shëndetësisë.

Konventa u kërkon shteteve të krijojnë mekanizma të qarta ligjorë dhe institucionale për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e këtyre veprave penale, duke kontribuar në forcimin e integritetit institucional dhe zbatimin efektiv të shtetit të së drejtës. Ky kuadër ndërkombëtar ofron jo vetëm një bazë të gjerë për zhvillimin e politikave kombëtare efektive, por edhe një presion të vazhdueshëm për zbatimin e standardeve të integritetit dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e qeverisjes.

• **Kuadri Ligjor Kombëtar në Shqipëri**

Kuadri ligjor dhe institucional në nivel kombëtar për luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë në Shqipëri është ndërtuar mbi një sërë normash penale dhe administrative që synojnë të adresojnë format më të rrezikshme të keqpërdorimit të pushtetit publik. Ky kuadër synon të parandalojë, identifikojë dhe ndëshkojë praktikat korruptive, veçanërisht në sektorët e ndjeshëm si administrata shtetërore dhe shëndetësia.

^[27] Ligji Nr .8778, datë 26.4.2001 “Për Ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin”



Në planin penal, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë përmban dispozita specifike që synojnë zyrtarët e nivelit të lartë. Nenet 245 dhe 260 kriminalizojnë korrupsionin pasiv dhe aktiv të funksionarëve publikë të lartë, përfshirë ministra, drejtues institucionesh qendrore dhe funksionarë të lartë në sektorin e shëndetësisë. Këto dispozita përbëjnë boshtin penal të ndëshkimit të sjelljeve korruptive të personave me pozita të larta. Po ashtu, neni 257 trajton rastet e shkeljes së barazisë në tendera dhe ankande publike, të cilat shpesh përdoren si mjet për favorizime klienteliste apo përfitime të paligjshme në dëm të interesit publik.

Po ashtu, ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar, përforcon më tej këtë qëllim, duke detyruar zyrtarët publikë, përfshirë ata në sektorin shëndetësor, të deklarojnë dhe shmangin çdo marrëdhënie apo situatë që mund të ndikojë në pavarësinë e vendimmarrjes së tyre, me qëllim shmangien e konflikteve të interesit, të cilat shpesh qëndrojnë në themel të praktikave korruptive. Një shtyllë tjetër kyçe e këtij kuadri është Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, zbatimi i të cilit në sektorin e shëndetësisë është veçanërisht i rëndësishëm për ekspozimin e formave të fshehta të korrupsionit. Ligji krijon struktura të posaçme për raportim të sigurt, parashikon sanksione për institucionet që dështojnë të mbrojnë sinjalizuesit dhe promovon një kulturë të etikës dhe transparencës në administratën publike.

Ndërkohë, Ligji nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) vendos standarde të qarta për transparencën, konkurrencën e ndershme dhe barazinë e trajtimit në procedurat e prokurimit. Në një sektor si ai i shëndetësisë, ku tenderat për barna, pajisje mjekësore apo ndërtim infrastrukture menaxhojnë miliona euro në vit, ky ligj përfaqëson një mekanizëm kyç për të frenuar ndërhyrjet politike, konfliktet e interesit dhe korrupsionin ekonomik të lidhur me vendimmarrjen publike.

Gjithashtu, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, përbën një instrument të rëndësishëm për aktorët mediatikë, organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve për të kërkuar dokumente mbi tenderat, auditimet, kontratat dhe vendimmarrjet e institucioneve shëndetësore. Ky ligj ndihmon në forcimin e llogaridhënies publike dhe promovimin e transparencës institucionale. Ky kuadër ligjor plotësohet nga një sërë institucionesh të specializuara që luajnë rol kyç në mbikëqyrjen dhe zbatimin e legjislacionit kundër korrupsionit. Ndër to përfshihen Agjencia e Prokurimit Publik (APP), Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes auditimeve të brendshme.



Në tërësi, kuadri kombëtar ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë në Shqipëri është i konsoliduar dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, sfida kryesore mbetet zbatimi i qëndrueshëm, i paanshëm dhe i guximshëm i këtij kuadri në praktikë, në mënyrë që të garantohen integriteti institucional dhe besimi publik në sistemin shëndetësor dhe administratën shtetërore në tërësi.

- **Instrumente të tjera ndërkombëtare me ndikim indirekt:**

Përveç instrumenteve ndërkombëtare të detyrueshme, ekzistojnë disa udhëzime dhe akte nënligjore me ndikim të rëndësishëm në mënyrë indirekte në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë, sidomos në sektorin e shëndetësisë dhe në administratën publike në tërësi. Këto instrumente ndihmojnë në promovimin e standardeve të transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në nivel ndërkombëtar dhe ofrojnë udhëzime praktike për përmirësimin e qeverisjes institucionale.

“OECD Guidelines for Managing Conflict of Interest in the Public Sector” (2003) përbëjnë një kornizë referuese për menaxhimin efektiv të konfliktit të interesit në sektorin publik. Udhëzimet promovojnë ndarjen e qartë ndërmjet detyrimeve zyrtare të nëpunësve civilë dhe interesave të tyre personale apo politikë, duke u fokusuar në masat parandaluese, kulturën e integritetit dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale. Këto parime janë veçanërisht të rëndësishme për sektorë të ndjeshëm si shëndetësia, ku ndërthurja ndërmjet vendimmarrjes publike dhe interesave të kompanive farmaceutike apo subjekteve të lidhura ekonomikisht me zyrtarë publikë krijon hapësira të konsiderueshme për korrupsion.

Plani Global i Veprimit i OBSH-së për Transparencën dhe Integritetin në Sektorin e Shëndetësisë (Transparency and Integrity in the Health Sector – ëHO Global Action Plan) ofron një platformë strategjike për vendet anëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë për të forcuar qeverisjen në shëndetësi, duke minimizuar rreziqet e korrupsionit dhe duke përmirësuar menaxhimin e burimeve publike. Plani thekson rëndësinë e sistemit të auditimit, monitorimit të barnave dhe prokurimeve, si dhe ndërtimin e strukturave të pavarura për denoncimin e praktikave abuzive në sektorin shëndetësor. Ai ka një rëndësi të veçantë për vendet në zhvillim, ku mungesa e mekanizmave të mbikëqyrjes i bën sistemet shëndetësore veçanërisht të ekspozuara ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.



Direktiva e Bashkimit Europian 2019/1937 “Për mbrojtjen e sinjalizuesve” (whistleblower Protection Directive), për të cilën Shqipëria është në proces përafrimi ligjor, përfaqëson një standard të avancuar në mbrojtjen e individëve që raportojnë shkelje të ligjit në sektorin publik apo privat. Kjo direktivë imponon krijimin e mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm për raportimin e veprave korruptive, garantimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjen nga represioni institucional apo hakmarrja. Në një kontekst si ai shqiptar, ku kultura e sinjalizimit është ende e brishtë dhe rreziqet për sinjalizuesit janë të larta, përafrimi dhe zbatimi efektiv i kësaj direktive do të përforcojë ndjeshëm kapacitetet për zbulimin dhe luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë, veçanërisht në sektorët e ndjeshëm si administrata publike dhe shëndetësia.

Në tërësi, këto instrumente ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin e korrupsionit përmes ndërtimit të integritetit institucional, edukimit etik, transparencës procedurale dhe fuqizimit të aktorëve të brendshëm që mund të sinjalizojnë praktikën abuzive. Edhe pse me karakter jo detyrues në disa raste, ndikimi i tyre në hartimin e politikave kombëtare dhe forcimin e standardeve të qeverisjes është thelbësor për vendet në tranzicion demokratik si Shqipëria.

• **Rëndësia strategjike e luftimit të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë**

Lufta kundër korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë përfaqëson një domosdoshmëri strategjike për garantimin e funksionimit të drejtë, të ndershëm dhe të qëndrueshëm të këtij sektori jetik për jetën dhe mirëqenien e qytetarëve. Kur funksionarët e lartë publikë abuzojnë me detyrën e tyre, pasojat nuk mbeten në sferën e abstrakte të administrimit shtetëror, por përkthehen në kosto të drejtpërdrejta njerëzore, ekonomike dhe sociale. Shpërdorimi apo keqadministrimi i burimeve publike shëndetësore nuk ndikon vetëm në uljen e cilësisë së shërbimeve, por prek në mënyrë të veçantë shtresat më të pambrojtura të shoqërisë, të cilat varen tërësisht nga sistemi publik për të përfituar kujdesin mjekësor bazë. Në këtë kuptim, korrupsioni minon parimet themelore të barazisë dhe drejtësisë sociale, duke thelluar pabarazitë dhe përjashtimin.

Zbulimi dhe ndëshkimi i rasteve të korrupsionit të lartë është po aq i rëndësishëm për forcimin e shtetit të së drejtës dhe rikthimin e besimit të qytetarëve te institucionet publike. Llogaridhënia institucionale nuk mund të ekzistojë pa garantuar ndëshkueshmërinë e atyre që, duke mbajtur pozita të privileguara, dëmtojnë interesin publik për përfitime personale apo politike. Luftimi i pandëshkueshmërisë së funksionarëve të lartë është një test i drejtpërdrejtë i angazhimit institucional ndaj sundimit të ligjit dhe ndershmërisë administrative.



Korrupsioni në sektorin e shëndetësisë ka gjithashtu një ndikim të drejtpërdrejtë në aspektin ekonomik, duke rritur kostot për qytetarët dhe duke ulur eficiencën e përdorimit të fondeve publike. Paratë që humbasin përmes praktikave korruptive nuk janë vetëm humbje për buxhetin e shtetit, por përkthehen në mungesë barnash, pajisjesh, personeli dhe përkujdesjeje adekuate për pacientët. Luftimi i korrupsionit garanton një shpërndarje më të drejtë të burimeve dhe një rritje të efektshmërisë së politikave shëndetësore, duke lehtësuar barrën ekonomike që sot rëndon padrejtësisht mbi individët dhe familjet.

Në kontekstin e procesit të integritetit evropian, Shqipëria ka detyrime të qarta për të siguruar një sistem shëndetësor që i përgjigjet standardeve të Bashkimit Evropian në drejtim të transparencës, integritetit dhe mirëqeverisjes. Progres-raportet e Komisionit Evropian kanë nënvizuar vazhdimisht nevojën për të luftuar korrupsionin në sektorët kyç të shërbimeve publike, me shëndetësinë në krye të listës. Për këtë arsye, ndërtimi i një sistemi të imunizuar nga ndërhyrjet politike dhe praktikat klienteliste nuk është vetëm një nevojë e brendshme për zhvillim të qëndrueshëm, por edhe një angazhim i patjetërsueshëm për të avancuar në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

Lufta kundër korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi nuk është vetëm një sfidë ligjore apo institucionale, por një angazhim moral dhe politik për të mbrojtur të drejtën e çdo qytetari për të jetuar me dinjitet dhe për të përfutur shërbime të ndershme, cilësore dhe të barabarta.

III. Perceptimi i publikut për korrupsionin e nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë



Pavarësisht përkufizimeve të qarta ligjore dhe sociale të korrupsionit të nivelit të lartë, në praktikë, për publikun shqiptar mbetet ende e vështirë të bëhet një dallim i qartë midis formave të ndryshme të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë. Kjo vështirësi buron kryesisht nga natyra e përvojës së drejtpërdrejtë që qytetarët kanë me sistemin shëndetësor, ku kontaktet fillestare zakonisht ndodhin në qendrat shëndetësore dhe spitalet rajonale. Për pasojë, perceptimi për korrupsion është më i theksuar në këtë nivel të ofrimit të shërbimeve, ku qytetarët përballen me praktika si ryshfeti për marrjen e trajtimit shëndetësor, favorizimet, apo mungesa e transparencës në komunikim dhe ofrim të shërbimeve.

Megjithatë, kur flitet për korrupsionin e nivelit të lartë në sektorin shëndetësor, tendenca është që ky të lidhet me shkelje më strukturore dhe sistematike, sidomos me keqpërdorimin e fondeve publike, manipulimin e procedurave të prokurimeve publike dhe mungesën e integritetit në hartimin dhe zbatimin e politikave shëndetësore. Në Shqipëri, raportime të ndryshme nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe media investigative kanë zbuluar praktika të dyshimta në tenderët për blerjen e barnave, pajisjeve mjekësore apo shërbimeve të mirëmbajtjes së infrastrukturës shëndetësore. Për shembull, janë konstatuar raste të kontratave të dhëna në mënyrë të parregullt, mungesë konkurruese në procedura, apo mbivlerësim i kostove për blerje të barnave dhe pajisjeve, që kanë sjellë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe përkeqësim të cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit 2024, e rendit Shqipërinë në vendin e 80 nga 180 vende në gjithë botën për sa i përket nivelit të perceptuar të korrupsionit në sektorin publik.²⁸ Për këtë arsye, është thelbësore të rritet ndërgjegjësimi për të kuptuar më mirë format e korrupsionit të nivelit të lartë dhe ndikimin e tyre afatgjatë në sistemin shëndetësor dhe të drejtat e pacientëve.

^[28] <https://www.transparency.org/en/cpi/2024>



- **Format më të përhapura të implikimit në korrupsion të funksioneve të larta shtetërore**

Korrupsioni në nivelet e larta të pushtetit përbën një kërcënim të madh për sundimin e ligjit, funksionimin e institucioneve demokratike dhe interesin publik në Shqipëri. Një analizë e formave më të përhapura të implikimit të funksionarëve të lartë shtetërorë në praktika korruptive është thelbësore për të kuptuar natyrën sistematike të këtij fenomeni dhe për të ndërtuar mekanizma të qëndrueshëm të parandalimit dhe ndëshkimit.

Në vija të përgjithshme, format më të zakonshme të korrupsionit të nivelit të lartë në Shqipëri përfshijnë:

- a) **Manipulimi i prokurimeve publike**, që konsiston në ndikimin e paligjshëm në procedurat e tenderimit, shpesh në bashkëpunim me aktorë ekonomikë privatë, për të siguruar përfitime personale ose në interes të grupeve të caktuara.
- b) **Emërimet klienteliste**, që konsiston në emërimin e personave në pozita kyçe në administratë apo institucione të pavarura mbi bazë të lidhjeve politike apo personale, duke anashkaluar meritokracinë dhe konkurrencën e ndershme.
- c) **Favorizime ekonomike për individë të afërt**, që konsiston në përdorimin e pushtetit për të mbështetur biznese të lidhura me familjarë apo miq përmes dhënies së lejeve, licencave, ose vendimeve administrative të personalizuar.
- d) **Ndikime në sistemin e drejtësisë**, që kryesisht lidhet me shfrytëzimin e funksioneve publike për të shmangur ndjekjen penale ose për të ndikuar në vendime gjyqësore dhe administrative në mënyrë të favorshme.

Ky lloj korrupsioni ka pasoja shumëdimensionale, duke ndikuar në cilësinë e kujdesit shëndetësor, shpërndarjen e pabarabartë të burimeve, përkeqësimin e shëndetit publik dhe uljen drastike të besimit të qytetarëve tek institucionet publike.



IV. Roli i medias si pushtet i katërt në raportimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi

- **Roli i medias në raportimin dhe informimin mbi rastet e korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë**

Roli i medias në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht të nivelit të lartë, është i njohur gjerësisht si një komponent themelor i demokracive funksionale dhe shtetit të së drejtës (rule of law). Në doktrinën politike dhe juridike, media konsiderohet si “pushteti i katërt”, pikërisht për shkak të aftësisë dhe rolit të saj për të kontribuar në mbajtjen nën kontroll, nën balancë dhe nën përgjegjësi pushtetet kryesore të shtetit: ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin. Kjo qasje teorike mbështetet fort në jurisprudencën ndërkombëtare dhe dokumentet themelore të të drejtave të njeriut, duke e ngritur median në një instrument kyç për ruajtjen e llogaridhënies dhe luftimin e keqpërdorimit të pushtetit publik.

Në këtë kontekst, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen *Handyside v. United Kingdom* (1976) ²⁹, ka theksuar se liria e shprehjes dhe në mënyrë të veçantë liria e medias përbën një nga bazat themelore të shoqërive demokratike, e domosdoshme për informimin e publikut mbi çështjet e interesit të përgjithshëm, përfshirë korrupsionin. Ky standard mbështet fuqimisht konceptin e medias si garant i transparencës institucionale dhe si mjet për ndërgjegjësimin qytetar mbi të drejtat, detyrimet dhe standardet që duhet të kërkohen nga qeverisja. ³⁰

Kuadri ligjor ndërkombëtar ofron një mbështetje të qartë për këtë funksion të medias. Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) garanton lirinë e shprehjes dhe të marrjes së informacionit, veçanërisht në rastet që prekin interesin publik. Në të njëjtën linjë, Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), në nenin 13, i njeh medias dhe shoqërisë civile një rol kyç në promovimin e integritetit dhe luftimin e korrupsionit. UNCAC detyron shtetet ratifikuese që të garantojnë qasjen në informacion publik, lirinë e medias për të raportuar pa frikë ndëshkimi, si dhe mbrojtjen e burimeve të informacionit, përfshirë sinjalizuesit.

^[29] [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57499%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57499%22]})

^[30] GjEDNJ, çështja *Handyside v. United Kingdom* (1976) [1].



Këto dispozita vendosin jo vetëm një detyrim për shtetet që të krijojnë kushte të favorshme për një media të lirë dhe të pavarur, por gjithashtu e kornizojnë median si një aktor institucional në sistemin e kontrollit dhe balancës. Nëse këto standarde respektohen dhe zbatohen në mënyrë efektive, media jo vetëm që ndihmon në informimin e publikut, por shërben si një katalizator për hetime penale, reformë institucionale dhe presion për ndryshim politik.

Në praktikë, media investigative ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në zbardhjen e aferave të korrupsionit të nivelit të lartë, duke ekspozuar skema komplekse abuzimi me fondet publike, konfliktet e interesit, lidhjet e fshehta ndërmjet zyrtarëve të lartë dhe aktorëve ekonomikë, apo shkeljet në procedurat e tenderimit dhe emërimeve. Megjithatë, edhe pse jo si identifikuese kryesore e rasteve, ka luajtur një rol të rëndësishëm në raportimin e shkeljeve të gjetura nga institucione të tjera.

Megjithatë, ushtrimi i këtij funksioni nga media kërkon një ambient të garantuar nga shteti për mbrojtjen e gazetarëve, qasjen në informacion dhe dokumentacion publik brenda afatit të përcaktuar në Ligjin për të Drejtën e Informimit dhe funksionimin e pavarur nga presioni politik ose ekonomik. Në realitetin shqiptar, sfidat për median hulumtuese mbeten të shumta, përfshirë intimidimin, paditë strategjike (SLAPP), mungesën e aksesit në dokumente zyrtare dhe kufizimet financiare. Prandaj, forcimi i kuadrit mbrojtës për gazetarët, zbatimi rigoroz i ligjit për të drejtën e informimit, dhe ndërtimi i një kulture gjyqësore që njeh rolin legjitim të medias në denoncimin e korrupsionit, janë masa urgjente për të forcuar luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë.

V. Raste konkrete të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri



Nga burimet kërkimore të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, janë identifikuar disa raste, ku për vetëm 9 prej tyre kishte të dhëna më të qarta për përmbushjen në dukje të kriterëve për t'u konsideruar raste të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë. Sakaq, kriteret e marra në konsideratë për identifikimin si të tilla, kanë konsistuar në: Së pari, rastet e identifikuar, përmbushin kriterin e llojit të veprës penale, e cila përputhet me përcaktimet e nenit 245 (Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë), dhe Nenit 260 (Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë). Së dyti, përmbushin kriterin e subjektit, pasi personat e implikuar në këto veprime korruptive, kanë mbajtur funksione të larta shtetërore në strukturat e shëndetësisë. Së treti, të gjitha rastet janë identifikuar përmes kanaleve mediatike dhe raporteve të insitucioneve, të cilësuar si burime lehtësisht të aksesueshme nga publiku.

Në momentin e mbledhjes së të dhënave, rastet janë konsideruar që i përmbushin kriteret në dukje, pasi për cilësimin juridik të një veprimi të caktuar si akt korruptiv i nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, janë përgjegjës organet hetimore dhe gjyqësore përkatëse. Për këtë shkak, në mbledhjen e informacionit është përdorur metoda e mbledhjes së informacionit zyrtar nga institucionet përgjegjëse. Konkretisht është kërkuar informacion i detajuar nga SPAK, GjKKO dhe GjAKKO, për secilin nga rastet në mënyrë që në konkludim të bëhet kryqëzimi i informacionit dhe rastet përveçse përmbushin kriterin e perceptimit si të tillë, përmbushin edhe kriterin formalo-ligjor për t'u cilësuar si të tillë.

• Në mënyrë të veçantë, janë identifikuar rastet e mëposhtme:

Nr.	Titulli i shkrimit mediatik	Media publikues e	Viti i Publikimit	Narrativa e publikimit sipas medias
1	“Prokuroria nis një tjetër hetim për tenderat e Ilir Beqajt”	Lapsi.al	2015	Krahas Prokurorisë së Krimeve të Rënda, tenderat dhe koncesionet e Ministrisë së Shëndetësisë po hetohen edhe nga prokuroria e Tiranës. Janë dy hetime të veçuara për raste të ndryshme, por që në thelb kanë të njëjtin dyshim: në Ministrinë e Ilir Beqajt është abuzuar me tenderat publikë e koncesionet. [...] Procedurat e Ministrisë së Shëndetësisë, Ilir Meqaj, të datës 21 prill të vitit 2014, kur ai vendosi të modifikojë dokumentet e tenderit për barnat për sëmundjet tumorale, përfshirë edhe herceptinën. ³¹

2	“Korrupsioni në shëndetësi/ 110 milion lekë për roje të QSUT-së vetëm për 72 ditë”	27.al	2016	Tenderat e drejtpërdrejtë të Ilir Beqajt për të siguruar roje private pranë spitaleve nxjerrin hapur korrupsionin që po ndodh në shëndetësi. Open Data Albania ka publikuar shifrat zyrtare të abuzimit, ku spikasin tenderat me prokurim të drejtpërdrejtë që do të thotë pa garë mes kompanive dhe me shuma të ekzagjeruara. 11 milionë lekë të reja janë shpenzuar përmes negocimit të drejtpërdrejtë për të siguruar roje privat për 72 ditë, për QSUT, qendra më e madhe shëndetësore në Shqipëri. Kjo vlerë e vënë në dispozicion nga shteti për një roje vetëm për 72 ditë, është një procedurë e kryer pa garë, a thua se në Shqipëri është e vështirë të gjeshe roje (në Shqipëri e kanë me shumë qef këtë profesion).
3	“Si po favorizohet Vilma Nushi e “Check Up”, fiton pa garë miliona euro të tenderave të protezave në spitale”	Bold News	Publikuar në vitin 2021 për investigim të kryer nga 2016-2021	Pezullimi i koncesionit të “Check Up” nuk e ka lënë pa para’ pronaren Vilma Nushi. Ogerta Manastirliu, apo drejtorët e spitaleve qendrorë dhe rajonalë, e kanë sajdisur me miliona euro të tjera, duke i “kompensuar” sadopak humbjet në këto kohë. BoldNews ka siguruar dokumentet e disa tenderave, të kryera në harkun kohor 2016 – 2021, të cilat kanë si objekte blerje implante ortopedike, pra hekurat/protezat apo pajisjet që vendosin pacientët me thyerje kockash. Megjithëse me një distancë prej 5 vitesh, fituesit dhe procedurat janë të njëjta; fituese del kompania “Trimed”, e zonjës Vilma Nushi. Madje, pa garë dhe me vlera shumë afër fondit limit. Por, le të analizojmë pikërisht dokumentet që ka siguruar redaksia jonë. ³²
4	Vilma Nushi në panik nga SPAK, si oligarkja e Check Up-it po 'zhduk' kompanitë për t'i shpëtuar burgut!	Pamfleti	Publikuar në vitin 2025 për investigim të kryer nga 2015-2020	Emri i Vilma Nushit personifikon aferën korruptive të koncesionit të Check up-it, ku vetëm me analiza të pakryera dhe rimbursimin e padrejtë të TVSH ka futur në xhep mbi 6 milionë euro. Edhe pse vjedhjet e kuçedrës së korrupsionit në bashkëpunim me kupolën e Ministrisë së Shëndetësisë janë faktuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, Vilma Nushi vijon të mbetet për SPAK një monument i pandëshkueshmërisë. Që pas themelimit të SPAK, Vilma Nushi ka ndërmarrë disa veprime, duke kamufluar dhe avulluar kompanitë e saj. ³³
5	Raporti i KLSH-së Korrupsion i frikshëm në FSDKSH, receta për njerëz që nuk jetojnë, skemë vjedhje me rimbursimin, depot farmaceutike jashtë kontrollit, ilaçe të skaduara në treg.	Papraskena	Publikuar në vitin 2024 për investigim të kryer nga 2014-2016	Një raport i fundit i Kontrollit të Lartë të Shtetit konfirmon edhe një herë se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor mbetet një nga organet publike më të korruptuara si dhe një nga gjeneratorët më të palodhur të skemave të mashtrimit e vjedhjeve në Shqipëri, përfitimit me barna të skaduara, receta fiktive dhe skema të tjera zhvatje. [...] Albana Adhami është një nga xhepat më të thellë të korrupsionit të Ogerta Manastirliut dhe kartelit mafioz të ilaceve, sektori më fitimprurës në Shqipëri. ³⁴

[32] Si po favorizohet Vilma Nushi e "Check Up", fiton pa garë miliona euro të tenderave të protezave në spitale |

[33] Vilma Nushi në panik nga SPAK, si oligarkja e Check Up-it po 'zhduk' kompanitë për t'i shpëtuar burgut! - Anti-Mafia

[34] Prapaskena | Prapaskena

6	“Koncesioni i laboratorëve mjekësorë nën hetim për korrupsion”	Reporter.al	Publikuar në vitin 2024 për investigim të kryer nga 2020-2022	Kontrata e kushtueshme e partneritetit publik privat për shërbimin e laboratorëve mjekësorë po hetohet për korrupsion nga Prokuroria e Posaçme, SPAK pas vlerësimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit se Ministria e Shëndetësisë e ka dhënë atë në kundërshtim me ligjin. Zbatimi i kontratës ka sjellë gjithashtu pasojat e para për pacientët dhe sistemin shëndetësor. ³⁵
7	KLSH padit zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë për koncesionin e laboratorëve. (respiratorët)	Reporter.al	2022	K Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kallëzuar në SPAK shtatë zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë për shkelje të dyshuara ligjore në dhënien me koncesion të shërbimit të laboratorëve. Tre zyrtarë të tjerë u kallëzuan për tenderin e blerjes së respiratorëve në kulmin e pandemisë së COVID-19. ³⁶
8	Koncesionet e hemodializës, prokuroria merr në pyetje zv. ministrin e Shëndetësisë.	Balkan Web	Publikuar në vitin 2016 për investigim të kryer nga 2015-2023	Zëvendësministri i Shëndetësisë, Klodian Rrjepaj, është marrë në pyetje nga Prokuroria për të dëshmuar në lidhje me koncesionet e hemodializës dhe sterilizimit. Prokuroria ka nisur hetimet në lidhje me procedurat dhe dhënien me koncesion të disa shërbimeve spitalore. Në hetim janë marrë koncesioni për hemodializën me vlerë 86 milionë dollarë, ai për sterilizimin e pajisjeve kirurgjikale me vlerë 100 milionë dollarë, si dhe koncesioni i check-up-it falas. ³⁷
9	Korrupsioni në shëndetësi, apeli i GjKKO, lë në burg Sekretaren dhe Zyrtaren e Ministrisë.	Gazeta SI	2023	Apeli i GjKKO-së ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë për Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë, Joana Duro dhe zyrtaren e lartë të shërbimeve publike Laura Shteto, të cilat janë në arrest nën akuzën e korrupsionit pasiv. [...] Ata u arrestuan më 2 qershor 2023, pasi dyshohet se Duro mori rryshfet 330 mijë lekë për të favorizuar kompaninë e Vladimir Topit në një tender të hapur nga Ministria për supervizionin për rikonstruksionin e qendrave shëndetësore në Tiranë dhe Durrës.[...] ³⁸

^[35] Koncesioni i laboratorëve mjekësorë nën hetim për korrupsion – Reporter.al

^[36] KLSH padit zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë për koncesionin e laboratorëve – Reporter.al

^[37] <https://www.balkanweb.com/koncesionet-e-hemodializes-prokuroria-merr-ne-pyetje-zv-ministrin-e-shendetesise/#gsc.tab=0>

^[38] Korrupsioni në Shëndetësi, Apeli i GjKKO-së lë në burg Sekretaren dhe zyrtaren e Ministrisë - Gazeta Si



VI. Analizë e përgjithshme e rasteve të identifikuara


• Trendi i korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi sipas vitit të ngjarjes

Në funksion të analizës së prirjeve të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin shëndetësor, është realizuar një klasifikim i rasteve të identifikuara sipas vitit të zhvillimit të ngjarjes. Qëllimi i këtij seksioni është të evidentojë periudhat kohore me ekspozim më të lartë ndaj korrupsionit në nivele të larta vendimmarrjeje dhe zbatimi.

Nga shqyrtimi i nëntë rasteve të analizuara, rezulton se vitet me përqendrimin më të madh të rasteve të korrupsionit **janë viti 2015 dhe viti 2022, të cilat përbëjnë secila 44.4% të totalit të rasteve të identifikuara**. Nga ana tjetër, një tendencë më e qëndrueshme (neutrale) në frekuencën e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë është vërejtur gjatë viteve 2017–2021, me një përfaqësim më të ulët, përkatësisht 22.2% e rasteve.

Të dhënat e përshkruara dhe të reflektuara në tabelën e mëposhtme (Tabela Nr. 1), sugjerojnë se ekspozimi ndaj korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin shëndetësor nuk ka ndjekur një trend të qëndrueshëm, por është i përqendruar në periudha të caktuara kohore, me kulme të qarta në vitet 2015 dhe 2022. Kjo mund të lidhet me dinamika të veçanta politike, institucionale ose me intensifikimin e kontrolleve nga organet mbikëqyrëse.

Tabela 1: Viti i raportimit të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë






Në analizën e kryer mbi nëntë rastet e identifikuara të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë, rezultojnë vetëm dy tregues thelbësorë lidhur me tipologjinë penale të veprimeve të raportuara:

- Vetëm 22.2% e rasteve (2 nga 9) janë të identifikuara qartësisht si raste të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë;
- Ndërkohë, 77.8% e rasteve të mbetura përmbajnë veprime të izoluara që nuk janë të kategorizuara qartë sipas një vepre penale të veçantë, duke munguar përcaktimi i saktë ligjor se cilës formë të korrupsionit i referohet. (Tabela Nr. 2)

Tabela 2: Forma e kryerjes së korrupsionit




Ky mosidentifikim i saktë penal krijon një terren konfuzioni për publikun, pasi në shumë raportime mediatike përdoren terma si "aferë korruptive" apo "korrupsion në shëndetësi" pa pasur një referim të qartë ndaj një dispozite konkrete ligjore ose akuze të formuluar nga organet proceduese. Kjo situatë pasqyron një mangësi në koordinimin ndërmjet raportimeve publike dhe informacionit zyrtar nga institucionet hetimore, duke e bërë të nevojshme që vlerësimi i rasteve të bazohet në burime të verifikuara dhe në respektim të parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë deri në vendim të formës së prerë.

Gjithashtu, vërehet një pasaktësi e konsiderueshme edhe në raport me formën konkrete të realizimit të korrupsionit, pasi në 88% të rasteve nuk sqarohet në mënyrë të detajuar se cilat veprime të veçanta përbëjnë korrupsionin. Në pjesën më të madhe të rasteve, bëhet fjalë për shkelje të procedurave të prokurimit publik, të cilat konsiderohen menjëherë si vepra penale korruptive pa u diferencuar në mënyrë juridike (Tabela Nr.3).



Analiza nxjerr në pah nevojën për kategorizim më të saktë penal dhe institucional të veprimeve të dyshuara për korrupsion, si dhe për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet mediave, institucioneve të drejtësisë dhe strukturave antikorrupsion. Vetëm në këtë mënyrë mund të rritet besueshmëria e publikut dhe të shmanget stigmatizimi i individëve pa një bazë të qartë ligjore, duke forcuar gjithashtu edhe kapacitetin institucional për të ndjekur penalisht rastet reale të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë.

Tabela 3: Roli i medias në raportimin e rasteve të korrupsionit të lartë në sektorin e shëndetësisë




Analiza e kryer përmes këtij studimi, e mbështetur nga të dhënat e pasqyruara në Tabelën e mëposhtme nr. 4, evidenton qartë prirjen mbi mënyrën e realizimit të veprimeve korruptive në rastet e analizuara. Nga shqyrtimi i nëntë rasteve të identifikuar, rezulton se:

- 88.9% e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë (në dukje) referohet se janë realizuar përmes veprimeve aktive, ku janë ndërmarrë vendime, ndërhyrje, ose janë kryer veprime konkrete që kanë krijuar favore të paligjshme për subjekte të tretë, ndërkohë, në 11.1% të rasteve nuk është e mundur të identifikohet me saktësi forma përmes së cilës është kryer veprimi i dyshuar korruptiv.

Përqindja e ulët e rasteve të paidentifikuara nuk sugjeron domosdoshmërisht një përfshirje përmes mosveprimit. Përkundrazi, duke pasur parasysh që korrupsioni, për të ekzistuar juridikisht dhe materialisht, kërkon përmbushjen e disa elementeve aktive thelbësore si: marrja e përfitimeve, të pasurit dijeni për premtimet apo dhëniet dhe njëkohësisht pranimet, ndërmarrja e veprimeve të favorizimit, apo ndikimi në proceset vendimmarrëse, mundësia që një veprim korruptiv të realizohet thjesht përmes mosveprimit mbetet teorikisht minimale dhe praktikisht e pamundur për t'u vërtetuar.



Tabela 4: Ana objektive e kryerjes së korrupsionit



• Burimet e raportimit të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë

Nga analiza e kryer mbi rastet e raportuara të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, rezulton se institucioni më aktiv dhe me kontributin më të madh në identifikimin dhe dokumentimin e këtyre rasteve është Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH). Si organ kushtetues me funksione audituese, KLSH ka shërbyer si burimi fillestar i informacionit për 55.6% të rasteve të analizuara, duke reflektuar rolin e tij qendror në auditimin e fondeve publike dhe monitorimin e performancës institucionale.

Në 11.1% të rasteve, është raportuar nga media se procedurat hetimore janë iniciuar nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), çka sugjeron një angazhim më të vonshëm, pas hetimit proaktiv nga institucionet e drejtësisë.


Media investigative, në mënyrë të pavarur dhe pa referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ndonjë institucion shtetëror, ka kontribuar në 33.3% të rasteve, përmes identifikimit të të dhënave, analizës së dokumenteve dhe denoncimit të praktikave të dyshimta të korrupsionit. Po ashtu, në 33.3% të rasteve të tjera, burimet e informacionit rezultojnë të jenë të ndryshme, të paidentifikuara qartë ose të përziera. Në mënyrë domethënëse, në asnjë nga nëntë rastet e analizuar nuk rezulton të ketë pasur raportim, kallëzim apo hetim të iniciuar nga institucione të tjera si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Komisioni Hetimor për çështjet në shëndetësi, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) apo shoqëria civile.

Kjo nuk përjashton katërcipërisht mundësinë që këto institucione apo organizma të kenë ndërmarrë veprime hetimore apo verifikime administrative, megjithatë, në bazë të referencave publike të disponueshme dhe raportimeve mediatike, nuk ka të dhëna të dokumentuara që të vërtetojnë një përfshirje të tyre të drejtpërdrejtë.



Në rastin e ILDKPKI, është e kuptueshme që kufizimi i aksesit të plotë në veprimtarinë e institucioneve publike mund të ndikojë në kapacitetin e tij për të evidentuar raste të mirëfillta të korrupsionit, ndryshe nga KLSH e cila ushtron funksionin e auditimit të thelluar financiar dhe performancës. Të dhënat tregojnë qartë një dominancë të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) si institucioni më i efektshëm në evidentimin e rasteve të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë, ndërsa roli i institucioneve të tjera mbikëqyrëse apo hetimore është dukshëm më i kufizuar në praktikë, të paktën në aspektin e transparencës publike të ndërhyrjeve të tyre. Kjo nënvizon nevojën për një përforsim të bashkëpunimit ndër-institucional, si dhe për një rishikim të kompetencave praktike dhe aksesit në informacion që kanë strukturat e tjera të kontrollit dhe shoqëria civile, në mënyrë që lufta kundër korrupsionit të mos mbetet e fragmentuar dhe të fitojë më shumë efektivitet në fazën parandaluese dhe ndëshkuese.

Tabela 5: Institucioni që ka kryer raportimin fillestar të rastit të korrupsionit të nivelit të lartë





- **Qasja e mediave dhe e raporteve ndaj parimit të prezumimit të pafajësisë së subjekteve të akuzuar për korrupsion të nivelit të lartë në shëndetësi**

Një nga parimet themelore të së drejtës penale, i sanksionuar si në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, legjislacionin e posaçëm ashtu edhe në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, është parimi i prezumimit të pafajësisë. Ky parim nënkupton se asnjë individ nuk mund të konsiderohet fajtor për kryerjen e një vepre penale, pa një vendim të formës së prerë të shpallur nga gjykata kompetente. Deri në momentin e dhënies së këtij vendimi, çdo subjekt i përfshirë në një procedim penal duhet të trajtohet si i pafajshëm.

Ky parim, megjithatë, nuk përjashton as median dhe as institucionet e tjera nga detyra për të informuar publikun dhe për të ngritur shqetësime të justifikuara në lidhje me indicie apo raste të dyshuara të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë. Ajo që është thelbësore në këtë kontekst është që informimi të realizohet në mënyrë të përgjegjshme, duke respektuar gjuhën profesionale, fazën e procedimit dhe statusin procedural të personit të përfshirë.

Në mënyrë të veçantë, është e nevojshme që ky komponent i së drejtës penale të shpjegohet për publikun në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme, duke siguruar që mosrespektimi i tij të mos çojë në stigmë sociale apo në deformim të perceptimit mbi Institucionet. Roli i medias mbetet i pazëvendësueshëm, por duhet të shoqërohet me raportim të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm mbi ecurinë ligjore të rasteve të ngritura.


Në interpretim të tabelës së mëposhtme (Tabela Nr. 6):

- Në 66.7% të rasteve të raportuara nga media, është respektuar në mënyrë të përgjegjshme parimi i prezumimit të pafajësisë. Raportimet kanë qenë të balancuara, duke paraqitur faktet, duke nënvizuar fazën hetimore ku ndodhet rasti dhe pa përdorur gjuhë akuzuese.
- Ndërkohë, në 33.3% të rasteve, janë vërejtur shkelje të këtij parimi. Media ka paraqitur akuza të drejtpërdrejta ndaj subjekteve të përfshira, pa u sqaruar nëse ka një procedim zyrtar të nisur ose pa përdorur terminologjinë e duhur ligjore. Kjo krijon rrezik për perceptime të gabuara publike dhe cenon të drejtat procedurale të subjekteve në fjalë.



Sakaq respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë është një standard ligjor dhe etik i domosdoshëm, i cili duhet të garantohet jo vetëm nga organet e drejtësisë, por edhe nga media si aktor i rëndësishëm në ndërtimin e opinionit publik dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin e shëndetësisë. Qasja e kujdesshme në raportim, përdorimi i terminologjisë së saktë dhe ndarja e qartë mes dyshimit dhe fajësisë së provuar janë elemente kyçe për ruajtjen e besueshmërisë institucionale dhe të drejtësisë. Forcimi i profesionalizmit të mediave dhe edukimi i publikut mbi parimet themelore të procesit penal është thelbësor për një shoqëri demokratike që respekton të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

Tabela 6: A respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë në raporte apo media dhe a i bëhet kjo e qartë publikut?



VII. Analizë e veçantë e rasteve të identifikuara



Në këtë seksion synohet të jepet një panoramë më e detajuar e secilit rast të identifikuar, duke paraqitur të dhënat e referuara nga burimet mediatike apo të raporteve konkrete, ecurinë e rastit ndër vite, si dhe ndërhyrjet konkrete institucionale në parandalimin apo ndëshkimin e rasteve. Në kuadër të metodës së triangulimit të informacionit, me qëllim identifikimin e statusit juridik të çështjeve dhe hapave konkretë të ndërmarrë nga institucionet ndëshkimore, TFL ka përcjellë kërkesa për informacion drejtuar GjKKO dhe GjAKKO.

Në përgjigje të kërkesës së TFL-së, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka përcjellë përgjigje të plotë përmes postës elektronike në datë 16.06.2025. Të dhënat e përcjella gjenden të përfshira në seksionet përkatëse të analizimit të secilit rast. Ndërsa në përgjigje të kërkesës së TFL-së, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka përcjellë përgjigje të plotë përmes postës elektronike në datë 09.06.2025. Të dhënat e përcjella gjenden të përfshira në seksionet përkatëse të analizimit të secilit rast.

Në parantezë, nënvizojmë se të dhënat e përcjella nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, e cila në mënyrë specifike ka referuar se: *“Sa i përket rasteve të identifikuara në kërkesën tuaj, nga pika 1 deri tek pika 7, konkretisht: tenderi për barnat e sëmundjeve tumorale; tenderi me vlerë 1.100.000 lekë për sigurimin e rojës private për 72 ditë për QSUT; tenderi për blerjen e materialeve të konsumit, implante ortopedike, me vlerë rreth 2.000.000 euro; koncesioni i “Check-Up”, raportuar nga media si aferë korruptive e kryer nga znj. Vilma Nushi, përmes shoqërisë tregtare Marketing & Distribution; çështja e Albana Çelës (Adhami), ish-drejtuese e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; tenderi për laboratorët mjekësor që i korrespondojnë procedimit penal nr. 18, datë 31.01.2022, të regjistruar pranë SPAK dhe tenderi për blerjen e respiratorëve gjatë pandemisë COVID-19, ju informojmë se pas verifikimeve të kryera në Kryesekretarinë e kësaj gjykate, deri më tani, **nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq apo kërkesë për pushim çështje lidhur me çështjet e sipërcituara.**”*

Sakaq, nuk mund të arrihet në konkluzionin se për rastet të cilat nuk janë të regjistruara në gjykatë, të mos jenë iniciuar hetime nga ana e Prokurorisë. Ekziston mundësia që për këto raste, hetimi të ketë filluar dhe hetimet të mos jenë mbyllur ose mundet që hetimet të jenë mbyllur në një nga format që parashikon ligji procedural penal.



Ndërkohë, në Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2024”, sa i takon korrupsionit të nivelit të lartë, është evidentuar se për vitin 2023 janë hetuar 6 raste të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror dhe i të zgjedhurve vendorë (200 %) krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë për vitin 2024 janë hetuar 4 raste (33.33%) krahasuar me 2023. Sakaq në raport specifikohet se kjo vepër vijon të mbetet vepër penale kryesore dhe përcaktuese në fushën e korrupsionit.³⁹ Megjithatë në këtë raport nuk specifikohet se cilat prej këtyre veprave janë kryer në sektorin e shëndetësisë.

• **Tenderi për barnat e sëmundjeve tumorale (2015)**

Në vitin 2015, tenderi i dhënë për barnat e sëmundjeve tumorale, është raportuar nga Lapsi.al, si rast i modifikimit të dokumenteve të tenderit nga ish-ministri i shëndetësisë z. Ilir Beqaj. Sipas kohës kur lajmi është publikuar në media, prokuroria ka pasur një hetim mbi dyshimet e ngritura për paracaktimin e fituesve dhe përjashtimin e operatorëve konkurrues. Më konkretisht, në media është raportuar se: “Krahas Prokurorisë së Krimeve të Rënda, tenderat dhe koncesionet e Ministrisë së Shëndetësisë po hetohen edhe nga prokuroria e Tiranës. Janë dy hetime të veçuara për raste të ndryshme, por që në thelb kanë të njëjtin dyshim: në Ministrinë e Ilir Beqajt është abuzuar me tenderat publikë e koncesionet. Tre janë koncesionet që po hetohen me iniciativë nga Prokuroria për Krimet e Rënda. Ndërsa prokuroria e Tiranës po heton disa tendera të blerjes së ilaçeve. Hetimet këtë herë kanë nisur me referim.”⁴⁰

Në zbatim të metodës së triangulimit dhe analizës së të dhënave, për të gjurmuar ndërhyrjen dhe hetimin e kryer nga ana e organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e fondeve publike, TFL është konsultuar me raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të vitit 2023 të titulluar “Raport Përfundimtar i Auditimit të Performancës për Trajtimin e Sëmundjeve Tumorale”,⁴¹ në të cilin janë konstatuar parregullsi në zbatimin e kontratës së koncesionit. Ky është jo vetëm indikator i qartë i neglizhencës në përmbushje të detyrimeve kontraktuale, por edhe tregues për mungesën e mekanizmave mbikëqyrës të brendshëm të zbatimit të saj. Në këtë prizëm, duhet theksuar se ka një monitorim ex post të zbatimit të kontratës dhe alokimit të fondeve publike, e megjithatë përpjekje më të shtuara duhet të ishin bërë nga institucionet përgjegjëse për të parandaluar fenomene të caktuara që mund të identifikohen si korrupsion i nivelit të lartë. Ndërkohë nuk ka të dhëna të tjera, nga institucione të tjera mbikëqyrëse apo gjyqësore lidhur me këtë çështje.

^[39]Raporti vjetor i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024.

^[40] <https://lapsi.al/2015/12/27/prokuroria-nis-nje-tjeter-hetim-per-tenderat-e-ilir-beqajt/>

^[41] <https://www.klsh.org.al/category/auditime/auditime-performance/>



• Tenderi për rojën private në QSUT (2016)

Rasti tjetër i përket tenderit me vlerë 1.100.000 lekë, për të cilin 27.al ka referuar në publikimin e saj, se është dhënë për sigurimin e rojës private në QSUT për një periudhë prej 72 ditësh, me procedurë të drejtpërdrejtë dhe pa garë. Ky veprim është raportuar nga media si keqpërdorim i fondeve publike dhe shkelje e barazisë në tëndera. Nuk ka informacion të raportuar për hetime të hapura penale ndaj këtij tenderi.⁴²

Më konkretisht, në media është raportuar se:

“11 milionë lekë të reja janë shpenzuar përmes negocimit të drejtpërdrejtë për të siguruar roje privat për 72 ditë, për QSUT, qendra më e madhe shëndetësore në Shqipëri. Kjo vlerë e vënë në dispozicion nga shteti për një roje vetëm për 72 ditë, është një procedurë e kryer pa garë, a thua se në Shqipëri është e vështirë të gjesh roje (në Shqipëri e kanë me shumë qejf këtë profesion). Një histori e gjatë anulimesh me arsye edhe qesharake si llogaritje gabim e fondit limit nga vetë autoriteti prokurues, ujen përmes shifrave zyrtare të monitoruara nga Open Data Albania.”

Lidhur me këtë rast, përveç raportimit në media, nuk ka të dhëna për ndjekjen penale të ndonjë funksionari të lartë të cilit mund t'i ngarkohet vepra penale e korrupsionit aktiv ose pasiv.

• Tenderi për implante ortopedike (2016-2021)

Tenderi për blerjen e implanteve ortopedike u raportua nga Bold News, si i fituar në kushte të mungesës së garës dhe transparencës. Në momentin e raportimit në kanalet mediatike nuk ka rezultuar të ketë pasur procedim penal aktiv mbi këtë tender. Më konkretisht, në media është raportuar se: *“BoldNews ka siguruar dokumentet e disa tenderave, të kryera në harkun kohor 2016 – 2021, të cilat kanë si objekte blerje implante ortopedike, pra hekurat/protezat apo pajisjet që vendosin pacientët me thyerje kockash. Megjithëse me një distancë prej 5 vitesh, fituesit dhe procedurat janë të njëjta; fituese del kompania “Trimed”, e zonjës Vilma Nushi.”*⁴³

Lidhur me këtë rast, përveç raportimit në media, nuk ka të dhëna për ndjekjen penale të ndonjë funksionari të lartë të cilit mund t'i ngarkohet vepra penale e korrupsionit aktiv ose pasiv.

^[42] <https://27.al/korrupsioni-ne-shendetesi-110-milion-leke-per-roje-te-qsut-se-vetem-per-72-dite/>

^[43] <https://openprocurement.al/sq/htender/view/id/3002>

<https://boldnews.al/2021/05/11/si-po-favorizohet-vilma-nushi-e-check-up-fiton-pa-gare-miliona-euro-te-tenderave-te-protezave-ne-spitale/>



• Koncesioni i Check-Up (2015–2020)

Lidhur me koncesionin e Check Up-it, është raportuar nga Pamfleti se vetëm me analiza të pakryera dhe rimbursimin e padrejtë të TVSH janë futur në xhep mbi 6 milionë euro. Më konkretisht, në media është raportuar se: *“Në një afat kohor prej 5 muajsh, njësia e kontrollit të brendshëm pranë Këshillit të Ministrave dhe prokuroria e Tiranës kanë zbuluar 2 skema të mëdha mashtrimi me barnat e rimbursueshme dhe faturat fiktive me ilaçe të shtrenjta. Por në 2015 shëndetësia shënoi debate të ashpra mes qeverisë dhe Partisë Demokratike për dhënien me koncesion të 3 shërbimeve bazë të shëndetësisë; check up, dializën dhe sterilizimin. Opozita akuzon se koncesionet janë dhënë klientëve të qeverisë Rama ndërsa prokuroria ka nisur hetimet për to. Ministri i shëndetësisë Ilir Beqaj ka mohuar akuzat duke argumentuar arsyet përse këto shërbime duhet t'i jepen privatit.”*⁴⁴

Në studim të këtij rasti, TFL ka konsultuar raportin e KLSH-së të vitit 2019, “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2018”⁴⁵ ku është evidentuar se nga auditimi mbi monitorimin e kontratës së kontrollit bazë CHECK-UP me PPP rezultoi se, edhe këtë vit (2018) nuk janë arritur projeksionet e kontratës duke bërë që, pagesat e marrë tepër nga koncesionari, për punën e pa kryer për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018, pra kosto shtesë progresive (duke zbritur shpenzimet stabël) është 801 milion lekë (241 milion lekë për shpenzimet variabël të kontrolleve të pa realizuara dhe 560 milion lekë TVSH-ja e faturuar ekëtij shërbimi), ndërsa për vitin 2018, kjo kosto shtesë llogaritet për 168 milion lekë (22 milion lekë për shpenzimet variabël të kontrolleve të pa realizuara dhe 146 milion lekë TVSH-ja e faturuar e këtij shërbimi).

Ndërkohë në “Raportin Vjetor të Performancës, KLSH 2024”,⁴⁶ përcaktohet se në lidhje me përputhshmërinë e planifikimit dhe zbatimit të fondeve speciale, nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), u evidentuan mangësi në procesin e rimbursimit të barnave, për të cilat FSDKSH nuk vuri në dispozicion të plotë, të dhënat e detajuara të rimbursimeve në nivel përfituesi me kode unike identifikuese, gjë që pamundësoi kryerjen e testeve të plota mbi verifikimin e legjitimitetit të rimbursimeve.

Pavarësisht kufizimit, për vitet 2021 dhe 2022, u konstatuan 60 raste të rimbursimeve të padrejta për pacientë që në fakt kishin ndërruar jetë. Këto raste, të shpërndara në rajone, mjekë dhe farmaci të ndryshme, tregojnë mangësi serioze në sistemin e kontrollit të skemës së rimbursimit.

^[44] <https://pamfleti.net/anti-mafia/vilma-nushi-ne-panik-nga-spak-si-oligarkja-e-check-up-it-po-zhduk-kom-i265426>

^[45] <https://www.klsh.org.al/category/auditime/auditime-performance/>

^[46] <https://www.klsh.org.al/category/auditime/auditime-performance/>



Në lidhje me rregullshmërinë e Listës së Barnave të Rimbursueshme (LBR) u konstatua se ajo nuk është hartuar dhe miratuar në kohën e duhur, duke mos përfshirë në skemë medikamente alternative më të lira, çka solli një kosto shtesë prej rreth 114 milionë lekë për buxhetin e Fondit. Në procesin e rimbursimit të barnave, për periudhën 01.01.2021-31.12.2022 janë evidentuar problematika dhe mangësi materiale dhe të përhapura, në bazë të të cilave është dhënë opinion i kundërt. [...]

Në vijim, sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka rezultuar se në 24 raste për vitin 2021, në vlerën 150,518 lekë dhe 36 raste për vitin 2022 në vlerën 221,843 lekë janë ekzekutuar receta me rimbursim për përfitues që kanë ndërruar jetë. Këto raste kanë materiale cilësore dhe janë të përhapura në rajone, mjekë e farmaci të ndryshme, pjesë e skemës së sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor e që përfshihen në procedurën e rimbursimit të barnave. Efektet e këtyre pasaktësive në fondet e rimbursimit mund të rezultojnë më të përhapura në të gjithë popullatën e përfituesve të rimbursimit.⁴⁷

Sa më sipër rezulton se KLSH, i ka kushtuar një kujdes veçantë monitorimit të fondeve publike të cilat kalojnë nëpërmjet FSDKSh tek subjektet private. Me gjithë alarmet e ngritura nga ana e KLSH-së, si dhe nga të dhënat që TFL ka në dispozicion aktualisht nuk rezulton se ka një procedim penal në ngarkim të ndonjë subjekti lidhur me këtë çështje. Eventualisht mund të jetë në hetim e sipër por në çdo rast mund të themi që në gjykatat e posaçme nuk ka një çështje të regjistruar për këtë rast.

• **Rasti i barnave të skaduara dhe recetave fiktive – FSDKSH (2014-2016)**

Lidhur me rastin e barnave të skaduara dhe recetave fiktive, nga media Prapaskena, wshtw raportuar se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor mbetet një nga organet publike më të korruptuara si dhe një nga gjeneratorët më të palodhur të skemave të mashtrimit e vjedhjeve në Shqipëri, përfitimit me barna të skaduara, receta fiktive dhe skema të tjera zhvatje. Më konkretisht, në media është raportuar se: *“Një raport i fundit i Kontrollit të Lartë të Shtetit konfirmon edhe një herë se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor mbetet një nga organet publike më të korruptuara si dhe një nga gjeneratorët më të palodhur të skemave të mashtrimit e vjedhjeve në Shqipëri, përfitimit me barna të skaduara, receta fiktive dhe skema të tjera zhvatje.*

^[47] <https://www.klsh.org.al/category/auditime/auditime-performance/>



Raporti i finalizuar në maj të vitit 2024, për auditimin e veprimtarisë së FSDKSH, gjatë periudhës janar 2022 deri në dhjetor 2022, fokusohet në menaxhimin e shpenzimeve të rimbursimit të barnave. [...]KLSH ka rekomanduar shkarkimin e Albana Çelës, e cila ka drejtuar FSDKSH gjatë periudhës 2020-2023. Por, Albana Çela (Adhami), që nga shtatori i vitit 2023, është zëvendësuar nga Spartak Zekja, gjithashtu një përfaqësues i kartelit të ilaçeve në Shqipëri, madje ish pronar i depove farmaceutike dhe një kompanie që ka përfituar edhe para publike. [...]”⁴⁸

Në plotësim të historikut të kësaj çështjeje, TFL ka konsultuar dy raportet e KLSH-së, ku nga secili ka rezultuar se: Sipas raportit të KLSH-së “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017”⁴⁹, nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në vendimmarrjet e organeve drejtuese të këtij institucioni, në menaxhimin e burimeve njerëzore, në administrimin e fondeve të rimbursimit të barnave, në monitorimin e kontratave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, në zbatimin e akteve ligjore, nënligjore lidhur me detyrat funksionale të punonjësve të Fondit, si dhe evidentohet dobësim i sistemeve të kontrollit gjatë vitit 2017, në të gjitha aspektet e funksionimit të këtij institucioni, që ka sjellë efekte negative për buxhetin e shtetit në shumën 3,865 milionë lekë.⁵⁰

Në sajë të auditimit të buxhetit të shtetit për vitin 2018, në raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit theksohet fakti se nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në drejtim të programimit dhe realizimit të buxhetit, në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe pagesave, në sistemin e kontrollit të subjekteve farmaceutike të cilat kanë kontratë me FSDKSH-në, në sistemin e kontrollit të paketave spitalore në dhënës privatë, në sistemin e rimbursimit të barnave spitalore dhe ekzaminimeve terciare, në shërbimet e realizuara të kontratave të shërbimeve me PPP, mangësi në hartimin dhe miratimin e udhëzimeve/rregulloreve dhe përmirësimin e rregulloreve e udhëzimeve aktuale, disa prej konstatimeve dhe shkelje të konstatuara edhe vite më parë. Gjithashtu, raporti nënvizon faktin se FSDKSH nuk ka vepruar për të minimizuar riskun e qarkullimit të barnave të skeduar në tregun farmaceutik.⁵¹

Edhe në këtë rast nuk ka të dhëna nga Gjykata për çështje të regjistruara pranë saj.

^[48] <https://prapaskena.com/2024/06/07/raporti-i-klsh-korrupsion-i-frikshem-ne-fsdksh-receta-per-njerez-qe-nuk-jetojne-skeme-vjedhje-me-rimbursimin-depot-farmaceutike-jashte-kontrollit-ilace-te-skaduara-ne-treg/>

^[49] <https://www.klsh.org.al/category/auditime/auditime-performance/>

^[50] Rapport i KLSH-së “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017.

^[51] Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për zbatimin e buxhetit të Shtetit”, 2018.



• **Koncesioni i laboratorëve mjekësorë (2020-2022)**

Në publikimin e Reporter.al, referohet se Kontrata e kushtueshme e partneritetit publik privat për shërbimin e laboratorëve mjekësorë po hetohet për korrupsion nga Prokuroria e Posaçme. Më konkretisht, në media është raportuar se: *“Shërbimi i laboratorëve mjekësorë është kontrata e katërt e partneritetit publik-privat në sektorin e shëndetësisë dhe parashikohet t’u kushtojë taksapaguesve rreth 13 miliardë lekë ose 114 milionë dollarë në 10 vitet e operimit. Kontrata u fitua nga konsorciumi “Labopharma” me seli në Tiranë, “Exalab” me seli në Francë dhe kompania guackë “AB Laboratory Solution” B.V e regjistruar në Hagë të Holandës dhe po zbatohet prej vitit 2020 nga kompania koncesionare “Laboratory Networks”. Procedurat e Ministrisë së Shëndetësisë për dhënien e këtij shërbimi me koncesion janë vënë në pikëpyetje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe po hetohen për korupsion nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, SPAK. [...]”⁵²*

Lidhur me këtë rast, përveç konstatimeve të kryera nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga burimet mediatike vërehet se ka një procedim penal të regjistruar nga ana e Prokurorisë së Posaçme, por nga të dhënat e përcjella nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë rezulton se kjo çështje nuk është dërguar ende për gjykim.

• **Tenderi për respiratorët gjatë pandemisë COVID-19 (2022)**

Tenderi për blerjen e 54 respiratorëve për pacientët me COVID-19 përfundoi me vetëm 5 respiratorë të furnizuar. KLSH kallëzoi tre anëtarë të komisionit të ofertave në janar 2022 për shpërdorim detyrë dhe shkelje të barazisë. Më konkretisht, në media është raportuar se: *“Përveç kontratës së shërbimit laboratorik, KLSH ka gjetur shkelje edhe në një tender për blerjen e respiratorëve gjatë emergjencës së shkaktuar nga COVID-19. Lidhur me këtë tender, janë kallëzuar në SPAK tre punonjës, anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. KLSH ka konstatuar se ka pasur furnizim të vonuar ose mungesë furnizimi me respiratorë. Në përfundim u siguruan vetëm 5 respiratorë, nga 54 që ishte planifikuar nevoja për përballimin e situatës Covid, duke rrezikuar kështu shëndetin publik, thuhet në raport. Nga auditimi i fondeve të caktuara për përballimin e COVID-19, KLSH thotë në raportin përmbledhës për buxhetin e shtetit 2020 se ka pasur mungesë të konsistencës së kodeve të projekteve të dedikuara për përballimin e situatës, duke e bërë gjurmimin e realizimit të tyre të vështirë ose thuajse të pamundur. [...]”⁵³*

Në të njëjtën formë, përveç konstatimeve të kryera nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe referencave mediatike, rezulton se në sistemin gjyqësor nuk ka një çështje të regjistruar me këtë objekt.

[52, 53] <https://www.reporter.al/2022/01/26/klsh-padit-zyrtaret-e-ministrise-se-shendetesise-per-koncesionin-e-laboratoreve/>



Për pasojë, nuk mund të themi që nuk mund të ketë një hetim penal në ngarkim të subjekteve të caktuara, sa kohë edhe nga media raportohet që janë kallëzuar në SPAK, 3 punonjës anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO). Për pasojë ecuria dhe trajtimi juridik i kësaj çështjeje mbetet evaziv.

• Koncesionet e Sterilizimit dhe Dializës (2015-2023)

Në vitin 2016 (viti i publikimit të lajmit), nga Balkan Web është referuar ish-Zëvendësministri i Shëndetësisë, është marrë në pyetje nga Prokuroria për të dëshmuar në lidhje me koncesionet e hemodializës dhe sterilizimit. Më konkretisht, në media është raportuar se: *“Zëvendësministri i Shëndetësisë, Klodian Rrjepaj, është marrë në pyetje nga Prokuroria për të dëshmuar në lidhje me koncesionet e hemodializës dhe sterilizimit. Hetimi për këtë çështje ka nisur nga Prokuroria që në dhjetor të vitit 2015, pas publikimeve në media të dyshimeve për abuzime. Prokuroria ka nisur hetimet në lidhje me procedurat dhe dhënien me koncesion të disa shërbimeve spitalore. Në hetim janë marrë koncesioni për hemodializën me vlerë 86 milionë dollarë, ai për sterilizimin e pajisjeve kirurgjikale me vlerë 100 milionë dollarë, si dhe koncesioni i check-up-it falas. [...]”*⁵⁴

Nga studimi i kryer nga TFL, mbi auditimet e kryera nga KLSH për këtë rast, dhe veçanërisht në “Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për Vitin 2018”, është konstatuar se fondet të cilat kanë shkuar për shpenzimet për nën Kontratat Koncesionare, të cilat monitorohen nga FSDKSH për vitin 2018, arritën në vlerën 3,578 milionë lekë, kështu: Nga auditimi i përmbushjes së përgjegjësisë lidhur me monitorimin dhe likuidimin e shërbimit të integruar të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile dhe furnizim me materiale mjekësore sterile, me PPP rezultoi se këtë vit, krahasuar me një vit më parë, vlera e këtij shërbimi është rritur për 954 milionë lekë, ose 84% më shumë se një vit më parë, rritje e pa parashikuar dhe jashtë parashikimeve të institucionit, duke krijuar detyrim të prapambetur në vlerën 306 milionë lekë. Nuk konstatohet që kjo rritje të ketë vënë në lëvizjestrukturat përgjegjëse për të analizuar faktorët dhe për të marrë masa për të mbajtur këtë lloj shpenzimi nën kontroll, por pa krijuar probleme në shërbimin ndaj qytetarit.⁵⁵

^[54] <https://www.balkanweb.com/lajm-i-fundit-koncesioni-i-sterilizimit-arrestohet-biznesmeni-ilir-rrapaj-dhe-ish-zv-ministri-i-shendetesise/>

^[55] Raport i KLSH, “Për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për Vitin 2018”.



Ndërsa nga konsultimi me dokumentin “Raport përfundimtar auditimi performance Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese hemodializa dialize peritoneale transplant”, të hartuar si rezultat i auditimit tematik të kryer nga KLSH-ja në vitin 2023, është konstatuar se nuk ka patur monitorim të vazhdueshëm për ofrimin e shërbimit, përzbatimin e kontratës së koncesionit për ofrimin e shërbimit të hemodializës, nga institucionet përgjegjëse (MSHMS dhe FSDKSH).

Sipas programit kombëtar mbi parandalimin, zbulimin e hershëm dhe mjekimin e sëmundjeve kronike të veshkave në Shqipëri, i hartuar nga Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, shërbimi, nefrologji - dializë - transplant, duhet të kryet monitorim vjetor për protokollin e ndjekur të hemodializës. MSHMS nuk e ka monitoruar në mënyrë periodike sipas kërkesave të kontratës koncesionare shërbimin e kryer nëpër spitalet e HD, duke mos u zbatuar dispozitat, lidhur me monitorim e shërbimit, mbajtjen e të dhënave dhe hartimin e raporteve.

Gjithashtu nga ana e KLSH-së është vërejtur se pas miratimit të raporteve nga Sekretari i Përgjithshëm i MSHMS, nuk është hartuar nga Drejtoria e Koncesioneve/PPP dhe Prokurimeve, plani i masave me qëllim adresimin e çështjeve të dala nga kontrolli. Shërbimi i dializës i është dhënë subjekteve private për periudha një vjeçare, nëpërmjet kontratave të lidhura nga drejtoritë rajonale të FSDKSH, pa zbatuar procedura të qarta konkurrimi. Aktet e nxjerra nga organet vendimmarrëse (FSDKSH) për lidhjen e kontratave, në përmbajtjen e tyre nuk kanë përcaktuar procedura të qarta që mund të plotësojnë apo zëvendësojnë rregullat e prokurimit publik. Po kështu, që nga dalja e Udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 4 date 24.03.2017 deri në kohën e ushtrimit të auditimit, kriteret që duhet të plotësojnë spitalet jopublike për dhënien e shërbimit, nuk janë përmirësuar dhe përditësuar në raport me dinamikën që vjen gjithnjë në rritje të licencimit të institucioneve shëndetësore jopublike të reja.⁵⁶

Alarmi për shkelje eventuale në tenderat për sterilizimin duket se ngrihet pas çdo auditimi nga KLSH, ku për vitin 2017 është konstatuar se: “me PPP rezultoi se këtë vit, krahasuar me një vit më parë, vlera e këtij shërbimi është rritur për 954 milion lekë, ose 84% më shumë se një vit më parë”. Ndërkohë nuk është evidentuar që për periudhën 2017-2018, pavarësisht konstatimeve të KLSH-së, të jenë ndërmarrë hapa konkretë nga ana e organeve hetimore apo edhe nga strukturat mbikëqyrëse të zbatimit të kontratave të PPP.

^[56] KLSH 2023 “Raport përfundimtar auditimi performance Shërbimi në Terapinë Renale Zëvendësuese hemodializa dialize peritoneale transplant”



Në të njëjtin raport të KLSH-së, sa i takon koncesionit për hemodializën, vërehet se nga auditimi mbi monitorimin e paketës së hemodializës, e cila zë peshën më tëmadhe të paketave spitalore në vlerën 2,095 milionë lekë, rezulton se 1,874 milionë lekë, ose 89% e kësaj vlere realizohet në subjekte privat dhe me PPP. Për vitin 2018, paketa e shërbimit të dializës me PPP u realizua në shumën 586 milionë lekë në krahasim me 410 milion lekë realizuar një vit më parë. Sipas kësaj kontrate koncesionare, Fondi duhet të paguajë koncensionarin për numrin e projektuar të pacientëve dhe seancave, pavarësisht se numri efektiv i pacientëve dhe i seancave është më i ulët se ai i projektuar.

Në raportin vjetor të performancës 2024, KLSH ka theksuar problematikat e identifikuara në çështjen e hemodializës, duke përcaktuar se: “Edhe për vitin 2023, kontrata koncesionare “Për ofrimin e hemodializës”, ka rezultuar me pagesa për shërbime të pakryera, konkretisht për 9241 raste nën projektion dhe 1557 raste mbi projektion, në shumën 103,527 mijë lekë. Në lidhje me financimin e kontratave PPP, ka rezultuar se në tre kontrata, vlera e financimit vjetor, si dhe parashikimet e financimit të tyre në PBA 2023-2025, janë përtej mbështetjes buxhetore të parashikuar për zbatimin e tyre, [...]”

Duke rezervuar të drejtat e KLSH-së mbi auditimin dhe gjetjet e konstatuara në fushat e sipërcituara, TFL vlerëson faktin që KLSH paraqet konsistencë në auditimin e fondeve publike në këtë sektor si dhe ngre alarmin në mënyrë periodike mbi shkeljet e konstatuara.

Lidhur me këtë çështje, pas kërkesës së Together for Life, drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, kjo e fundit ka përcjellë të dhëna të detajuara të çështjes duke përcaktuar se: *“Në datë 29.03.2024 është regjistruar kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 13 të vitit 2020 ndaj të pandehurve Ilir Beqaj, Klodian Rjepaj, Ilir Rrapaj, Marsela Serjani, Saimir Kadiu, Petref Mersini, Arben Gjata, Genc Burazeri dhe Naile Ajazi (Abazi)”, e cila është hedhur në short me datë 02.04.2024. Kjo çështje penale, lidhet me Kontratën e Koncesionit/Partneritet Publik Privat, me objekt “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikalë sterilë, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, zhvilluar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë.*



Me vendimin Nr. 13/69, datë 23.01.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: “I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. II. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. 13, të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në ngarkim të të pandehurve:

1. Ilir Beqaj, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal;
2. Klodian Rjepaj, akuzuar për kryerjen e veprave penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, kryer në bashkëpunim të posaçëm, atë të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga nenet 135, 28/4 e 334/1 të Kodit Penal; “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal, dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 e 25 të Kodit Penal, etj. [...]” Aktualisht, çështja në ngarkim të shtetasit Ilir Beqaj është e ndarë nga gjykimi i dosjes penale në ngarkim të të pandehurve Klodian Rjepaj, Ilir Rrapaj, Marsela Serjani, Saimir Kadiu, Petref Mersini, Arben Gjata, Genc Burazeri dhe Naile Ajazi (Abazi) pasi për këta të fundit zhvillohet me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe ndodhet në fazën e paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga ana e Prokurorisë.⁵⁷

Si rezultat i sa më sipër, nuk ka një vendim të formës së prerë për deklarimin fajtor të të pandehurve sa kohë nuk është dhënë ende vendimi penal i Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

• Tenderi i supervizimit të qendrave shëndetësore në Tiranë dhe Durrës (2023)

Në një artikull të publikuar nga GazetaSi.al, referohet se Ish-zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë u arrestuan për korrupsion pasiv në tenderin e supervizimit të qendrave shëndetësore. Më konkretisht, në media është raportuar se: “Apeli i GJKKO-së, ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë për Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë, Joana Duro dhe zyrtaren e lartë të shërbimeve publike Laura Shteto, të cilat janë në arrest nën akuzën e korrupsionit pasiv.

^[57] Përgjigje e përcjellë elektronikisht në datë 16.06.2025, nga ana e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.



Togat të zeza të Apelit nuk pranuan kërkesën e tyre për masë më të butë se arresti në burg. Më herët, GJKKO, vendosi ta lirojë nga qelia duke caktuar “arrest në shtëpi” për Vladimir Topin, administrator i kompanisë fituese të tenderit të Ministrisë së Shëndetësisë për supervizimin e qendrave shëndetësore në Tiranë dhe Durrës. Ndërkohë për inxhinierin e kompanisë "Dricons" shpk, Silvi Shehu, GJKKO vendosi masën e arrestit në burg pa afat. Ata akuzohen për korrupsion aktiv, ndërsa togat e zeza caktuan masë më të butë për administratorin për shkak të moshës.[...]”⁵⁸

Lidhur me këtë çështje, në përgjigjen e përcjellë nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është evidentuar fakti se më datë 17.07.2023 është regjistruar kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me objekt “Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 10/1 të vitit 2023, me të pandehur Joana Duro, Laura Shteto, Vladimir Topi dhe Silvi Shehi”. Me vendimin nr. 75, datë 13.11.2023 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurës Joana Duro, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 (katër) vjet burgim. [...]

Deklarimin fajtor të të pandehurës Laura Shteto, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 245 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim. [...]”.

Ndërkohë, pas ankimit të ushtruar nga subjektet në ngarkim të të cilëve është dhënë dënimi, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 19, datë 10.05.2024, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 75, datë 13.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si më poshtë: Deklarimin fajtor të të pandehurës Joana Duro, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, e parashikuar nga neni 259, paragrafi dytë i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 4 (katër) vjet burgim. [...]

Deklarimin fajtor të të pandehurës Laura Shteto, për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 244, paragrafi dytë, në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal dhe dënimin e saj me 1 (një) vit burgim. [...]”

Sakaq rezulton se cilësimi juridik i veprës penale i bërë nga Gjykata e Posaçme e Apelit, është më i butë se ai i dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, ndërkaq niveli i dënimit me burgim është i të njëjtit nivel.

^[58] <https://gazetasi.al/korrupsioni-ne-shendetesi-apeli-i-gjtko-se-le-ne-burg-sekretaren-dhe-zyrtaren-e-ministrise/>

VIII. Dëmet efektive dhe eventuale në sistemin e shëndetësisë si rezultat i korrupsionit të nivelit të lartë



Dëmet ekonomike dhe buxhetore përbëjnë një ndër pasojat më të theksuara të abuzimeve në sistemin shëndetësor. Përmes dhënies së kontratave koncesionare dhe kontratat e partneritetit publik privat (PPP) në mënyrë të paracaktuar, pa konkurrencë reale dhe me çmime të fryra, ngre premisa për dëmtimin e efikasitetit në përdorimin e financave publike. Ky shpërdorim përkthehet në një ngarkesë të drejtpërdrejtë për taksapaguesit shqiptarë, të cilët përballojnë një faturë financiare të pajustifikuar, ndërkohë që përballen me mungesa në barnat dhe trajtimet esenciale. Për më tepër, qytetarët shpesh mund të detyrohen të paguajnë nga xhepi për pajisje apo shërbime që në parim duhet të ofrohen falas ose të rimbursohen, duke përjetuar një barrë të dyfishtë financiare. Pikërisht këto ekuilibra synohen të mbrohen nga legjislacioni penal, duke qenë se vepra penale e korrupsionit të funksionarëve të lartë shtetërorë bën pjesë në grupin e krimeve kundër autoritetit të shtetit.

Në planin human dhe mjekësor, këto abuzime thellohen dhe ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe jetën e pacientëve. Raste të dokumentuara tregojnë për vonesa kritike në trajtime jetike, si rezultat i mungesës së ilaçeve për pacientët onkologjikë. Kjo situatë jo vetëm që përbën rrezik të drejtpërdrejtë për jetën, por përbën gjithashtu një shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë dhe në kohë, e garantuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qytetarët, në veçanti ata që i përkasin grupeve të marginalizuara, përballen me pengesa reale në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor, duke rrezikuar përkeqësim të gjendjes shëndetësore apo pasoja të pakthyeshme mjekësore.

Pasojat shtrihen edhe në aspektin institucional dhe sistematik të shërbimit shëndetësor. Përzgjedhja e ofruesve të shërbimeve pa një proces transparent dhe konkurrues **ka sjellë rrezik për menaxhimin dhe sigurinë në institucione kyçe si QSUT.**⁵⁹ Kjo cenon jo vetëm standardet profesionale, por edhe vetë kapacitetin e sistemit për të garantuar trajtim të sigurt dhe cilësor.

Në aspektin shoqëror dhe atë të perceptimit të qytetarëve, praktikab abuzive cenojnë rëndë besimin e qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore që ofrojnë shërbime shëndetësore.

^[59] Rasti i tenderit për roje.



Mungesa e llogaridhënies dhe raportimet e përsëritura për keqpërdorim të fondeve krijojnë një klimë mosbesimi të qytetarëve ndaj institucioneve qendrore dhe vartëse që kanë për detyrë të garantojnë shërbime mjekësore adekuate por edhe të kontrollojnë dhe mbikëqyrin dhe institucioneve të saj vartëse. Si rrjedhojë, qytetarët janë gjithnjë e më të prirur t'i drejtohen sektorit privat, i cili perceptohet si më i besueshëm, pavarësisht kostove më të larta. Kjo tendencë thellon pabarazitë sociale dhe përjashton nga sistemi shëndetësor publik ata individë që nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar shërbimet private.

Nga pikëpamja juridike dhe ndërkombëtare, shkelja e normave të legjislacionit penal, legjislacionit për prokurimet publike apo standardeve të Bashkimit Evropian sa i takon rregullave të konkurrencës dhe transparencës nuk përbën vetëm çështje të brendshme shtetërore. Praktikrat e konstatuara nëpërmjet vendimeve të Gjykatës së Posaçme për të cilat ka konkluduar me vendim fajësie për korrupsion pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror dhe i të zgjedhurve vendor janë tregues të qartë të shkeljeve dhe dëmeve të ardhura në sistemin shëndetësor.

Në planin ndërkombëtar, **prishja e reputacionit dhe imazhit të shtetit shqiptar,** me një prezencë të lartë të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë pas, sjell humbjen e besimit edhe tek partnerët ndërkombëtarë, çka sjell reduktimin e granteve të dhëna për shtetin shqiptar e njëkohësisht vonon procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Thënë sa më sipër, dëmet që rrjedhin nga këto praktika nuk kufizohen vetëm brenda mureve të spitaleve apo zyrave të institucioneve por ato prekin drejtpërdrejt jetën e përditshme të njerëzve. Bëhet fjalë për qytetarë që nuk marrin ilaçet në kohë, për familje që përballen me kosto të papërballueshme për trajtime thelbësore, për pacientë që humbin shpresën ndaj një sistemi që duhet t'i mbrojë. Kjo situatë përfaqëson një krizë të thellë të menaxhimit publik, ku dështimet ekonomike, shoqërore, institucionale dhe ligjore përzihen me njëra-tjetrën, duke krijuar pasiguri dhe pabarazi. Për të ndryshuar këtë realitet, nevojitet më shumë sesa thjesht reformë *“si e zeza mbi të bardhë”* por sugjerohet një ndërhyrje e menjëhershme dhe e bashkërenduar, me përkushtim real nga institucionet dhe përgjegjshmëri e lartë.

IX. Konkluzione dhe rekomandime



Në përfundim, pas analizimit të aspekteve të rëndësishme të korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë, si dhe pas kryqëzimit të informacionit dhe interpretimit logjik të të dhënave, shoqata Together for Life ka arritur në disa deduksione logjike për situatën në vend, deduksione për të cilat ka hartuar edhe rekomandime për përmirësimin e situatës në të ardhmen. Në mënyrë të veçantë, disa nga gjetjet dhe rekomandimet janë si më poshtë vijon:

Nga të gjitha rastet e analizuara, në dukje si korrupsion i nivelit të lartë në shëndetësi, ka rezultuar se fusha më e prekur nga ky fenomen, është fusha e koncesioneve dhe kontratave të pratisjes publik-privat. Konkretisht, kjo rjedh nga shkëlqja e procedurave të perzgjedhjes së subjektit fitues të procedurave të tenderimit, çka përforcon premisat për korrupsion dhe përvetësim fondesh.

Periudha kohore e cila është identifikuar si periudha me përqendrimin më të madh të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi (në dukje), janë viti 2015 dhe viti 2022, të cilat përbëjnë secila 44.4% të totalit të rasteve të identikuara. Kjo mund të lidhet me dinamika të veçanta politike, institucionale ose me intensifikimin e kontroleve nga organet mbikëqyrëse.

Vetëm 22.2% e rasteve (2 nga 9) janë të identikuara qartësisht si raste të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë, të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë, 77.8% e rasteve të mbetura përmbajnë veprime të izoluara që nuk janë të kategorizuara qartë sipas një veprë penale të veçantë, duke munguar përcaktimi i saktë ligjor se cilës formë të korrupsionit i referohet. Ky mosidentifikim i saktë penal krijon një terren konfuzioni për publikun, pasi në shumë raportime mediatike përdoren terma si "aferë korruptive" apo "korrupsion në shëndetësi" pa pasur një referim të qartë ndaj një dispozite konkrete ligjore ose akuze të formuluar nga organet proceduese.

Nga analiza e kryer, ekspertët e TFL kanë konstatuar se në shumicën e rasteve media dhe KLSH, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në identifikimin dhe adresimin e rasteve të korrupsionit. Ndërsa nga burimet mediatike nuk ka rezultuar se rastet e analizuara të jenë raportuar nga institucione të tjera si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Komisioni Hetimor për çështjet në shëndetësi, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), apo nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale.



Pra, të dhënat tregojnë qartë një dominancë të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) si institucioni më i efektshëm në evidentimin e rasteve të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë.

Ndërkaq, **rekomandohet një bashkëpunim institucional më të koordinuar për institucionet të cilat kanë rezultuar me një rol më pak aktiv në raportimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në shëndetësi.** Kjo do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien institucionale kundrejt publikut dhe shtetit shqiptar. Dëmet faktike të shkaktuara ose ato eventuale që mund të shkaktohen, si pasojë e veprave penale të korrupsionit të funksionarëve të lartë shtetëror, janë të një natyre kolosale qoftë nga efektet negative të drejtëpërdrejta në shëndetin dhe në jetën e konsumatorëve të shërbimeve shëndetësore, qoftë në pikëpamje të dëmeve në ekonominë individuale të qytetarëve dhe ekonominë në tërësi të shtetit shqiptar.

Kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar është i plotësuar në tërësinë e tij. Pavarësisht që me ndryshimin e dinamikave shoqërore, ekonomike dhe politike, legjislacioni ka nevojë të përshtatet me to dhe të përmirësohet. Për më tepër sugjerohet harmonizimi i legjislacionit shqiptar me atë të *acquis communautaire* duke e përshtatur me kontekstin socio-ekonomik shqiptar dhe nevojën për asgjësimin gradual të problemeve sistemike të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri.

Sa i takon kuadrit institucional dhe zbatimit të detyrave integrale të institucioneve përgjegjëse, konstatohet se ka një hendek të gjerë midis asaj që duhet bërë dhe asaj që është bërë. Në mënyrë të veçantë, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale së bashku me struktura të tjera të institucionale, **duhet të rrisin vigjilencën në kontrollin e brendshëm periodik e të mëvetësishëm të zbatimit të kontratave koncesionare të dhëna ndër vite.** Përveç kësaj, sugjerohet edhe përfshirja e aktorëve të tjerë të pavarur që nuk janë të ngarkuar me detyra publike, por që me ekspertizën e tyre mund kontribuojnë pozitivisht në luftën kundër korrupsionit.

Ndërhyrjet konkrete në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë në sektorin e shëndetësisë janë një tjetër komponent i rëndësishëm. **Sa i takon ndërhyrjeve “soft” dhe atyre me natyrë bashkërenduese, sugjerohet koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë institucional në sajë të rritjes së ndërgjegjësimit të aktorëve shtetëror (korrupsioni pasiv) dhe qytetarëve (korrupsioni aktiv) mbi rëndësinë dhe efektet negative të korrupsionit në këtë sektor, penalitetet që legjislacioni penal i akordon personave të cilët inkriminohen aktivisht ose pasivisht në akte korruptive të nivelit të lartë, si dhe format e sinjalizimit dhe raportimit të korrupsionit në këtë sektor. Në të kundërt ndërhyrjet “hard” përfshijnë ashpërsimin e sanksioneve në legjislacionin penal si dhe rritja e kontrolleve dhe e auditimit të brendshëm institucional.**



Auditimet e përgjithshme dhe tematike të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, kanë ndikuar pozitivisht duke dhënë një panoramë më të qartë të infektimit të strukturave të larta të shëndetësisë me korrupsion apo akte të ngjashme. Megjithatë, mbetet problematike moszbatimi në kohë reale i rekomandimeve të lëna nga ana e KLSH-së nga institucionet publike duke thelluar më shumë pasojat e akteve të konsideruara në dukje si korrupsion i nivelit të lartë. Në këtë drejtim **sugjerohet fortifikimi i mekanizmave të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.**

Nga studimi i raportit vjetor të SPAK, “Mbi veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme gjatë vitit 2024”, sa i takon korrupsionit të nivelit të lartë, është evidentuar se për vitin 2023 janë hetuar 6 raste të korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetëror dhe i të zgjedhurve vendorë (200 %) krahasuar me vitin 2022. Ndërkohë për vitin 2024 janë hetuar 4 raste (33.33%) krahasuar me 2023. Sakaq në raport specifikohet se kjo vepër vijon të mbetet vepër penale kryesore dhe përcaktuese në fushën e korrupsionit.⁶⁰

Megjithatë, në këtë raport nuk specifikohet se cilat prej këtyre veprave janë kryer në sektorin e shëndetësisë. Ndodhur në këto kushte, **në kuadër të informimit të publikut në mënyrë sa më të qartë dhe transparente, por edhe në sajë të vënies në dispozicion të të dhënave për studiues të ndryshëm, sugjerohet që në varësi të seksioneve raportuese, çështjet me fokus shëndetësinë të jenë më të identifikueshme dhe të plota.**

Ngritja e strukturave të tjera institucionale, **në formën e një taskforce** që të përfshijë aktorë të shoqërisë civile, media dhe institucione të caktuara me kompetenca kontrolluese dhe audituese për të bërë auditim institucional në të gjitha institucionet shëndetësore për të matur dhe identifikuar rastet e korrupsionit të nivelit të lartë si dhe për të koordinuar veprimet në luftën kundër korrupsionit.

Në rastet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në të shumtën e rasteve, auditimet kryhen për monitorim të fondeve publike, ndërkohë që një strukturë që mund të jetë mbështetëse, zgjatin ose e mëvetësishme nga KLSH, **mund të identifikojë edhe raste të tjera aferash korruptive të cilat nuk lidhen me përfitime monetare por me përfitime të tjera të cilat nuk janë të identifikueshme përmes dokumentacionit të shkruar. Kjo formë nuk synon mbivendosjen e tagrave institucionale të SPAK, por në krijimin e një strukture administrative që të ndjekë kryesisht, periodikisht rastet eventuale të korrupsionit në shëndetësi dhe jo vetëm.**

^[60] <https://konsultimipublik.al/konsultime/18>



Gjithashtu, TFL sugjeron edhe nxitjen e bashkëpunimit dhe mbështetjes së iniciativave të shoqërisë civile për monitorimin e institucioneve të shëndetësisë duke iu dhënë akses në informacion dhe dokumentacion deri në kufijtë e lejuar të ligjit, pa abuzuar me “kufijtë e kufizimit të informacionit”. Shoqëria Civile është një aleat i pavarur dhe i paanshëm në ruajtjen e parimeve të shtetit të së drejtës dhe luftës kundër korrupsionit në sektorin e shëndetësisë. Në vetvete sjell një ekspertizë me qasje për zgjidhjen e problematikave të identifikuara në terren nga bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha kategoritë e shtresave shoqërore, madje deri aty ku vetë institucionet mund të mos jenë të informuar për problematika të caktuara. Kjo nënvizon nevojën për një përforcim të bashkëpunimit ndërinstitutional, si dhe për një rishikim të kompetencave praktike dhe aksesit në informacion që kanë strukturat e tjera të kontrollit dhe shoqëria civile, në mënyrë që lufta kundër korrupsionit të mos mbetet e fragmentuar dhe të fitojë më shumë efektivitet në fazën parandaluese dhe ndëshkuese.

Nga rezultatet e analizës, sugjerohet kryerja e një kategorizimi më të saktë penal dhe institucional të veprimeve të dyshuara për korrupsion, nga ana e subjekteve raportues mediatik. Në mënyrë të veçantë, TFL sugjeron **respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë si një standard ligjor dhe etik të domosdoshëm, i cili duhet të garantohet jo vetëm nga organet e drejtësisë, por edhe nga media si aktor i rëndësishëm në ndërtimin e opinionit publik dhe luftën kundër korrupsionit në sektorin e shëndetësisë.** Qasja e kujdesshme në raportim, përdorimi i terminologjisë së saktë dhe ndarja e qartë mes dyshimit dhe fajësisë së provuar janë elemente kyçe për ruajtjen e besueshmërisë institucionale dhe të drejtësisë. Vetëm në këtë mënyrë mund të rritet besueshmëria e publikut dhe të shmanget stigmatizimi i individëve pa një bazë të qartë ligjore, duke forcuar gjithashtu edhe kapacitetin institucional për të ndjekur penalisht rastet reale të korrupsionit në sektorin e shëndetësisë.

X. Bibliografi dhe referenca



A. Referenca mediatike

- <https://lapsi.al/2015/12/27/prokuroria-nis-nje-tjeter-hetim-per-tenderat-e-ilir-beqajt/>
- <https://27.al/korrupsioni-ne-shendetesi-110-milion-leke-per-roje-te-qsut-se-vetem-per-72-dite/> <https://openprocurement.al/sq/htender/vieë/id/3002>
- Si po favorizohet Vilma Nushi e "Check Up", fiton pa garë miliona euro të tenderave të protezave në spitale|
- <https://pamfleti.net/anti-mafia/vilma-nushi-ne-panik-nga-spak-si-oligarkja-e-check-up-it-po-zhduk-kom-i265426>
- <https://prapaskena.com/2024/06/07/raporti-i-klsh-korrupsion-i-frikshem-ne-fsdeksh-receta-per-njerez-qe-nuk-jetojne-skeme-vjedhje-me-rimbursimin-depot-farmaceutike-jashte-kontrollit-ilace-te-skaduara-ne-treg/>
- <https://www.reporter.al/2022/07/01/konkesioni-i-laboratoreve-mjekesore-nen-hetim-per-korrupsion/>
- <https://www.reporter.al/2022/01/26/klsh-padit-zyrtaret-e-ministrise-se-shendetesise-per-konkesionin-e-laboratoreve/#:~:text=KLSH%20ka%20konstatuar%20se%20ka,ose%20munges%C3%AB%20furnizimi%20me%20respirator%C3%AB>
- <https://www.balkanweb.com/konkesionet-e-hemodializes-prokuroria-merr-ne-pyetje-zv-ministrin-e-shendetesise/#gsc.tab=0>
- <https://gazetasi.al/korrupsioni-ne-shendetesi-apeli-i-gjeko-se-le-ne-burg-sekretaren-dhe-zyrtaren-e-ministrise/>

B. Referenca nga raporte

- <https://www.transparency.org/en/our-priorities/grand-corruption>
- <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/publications/Anticorruption%20Methods%20and%20Tools%20in%20Health%20Lo%20Res%20final.pdf>
- https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Fjalori_Antikorrupsion_AL.pdf
- <https://www.transparency.org/en/cpi/2024>
- <https://konsultimipublik.al/konsultime/18>
- <https://www.klsh.org.al/category/auditime/auditime-performance/>
- Raporti vjetor i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2024.
- Raport i KLSH-së “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017.
- Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për zbatimin e buxhetit të Shtetit”, 2018.
- Raport i KLSH, “Për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për Vitin 2018”.
- KLSH 2023 “Raport perfundimtar auditimi performance Sherbimi ne Terapine Renale Zevendesuese hemodializa dialize peritoneale transplant”.



C. Referenca ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare

- Ligj nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
- Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Ligji Nr.10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligj Nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9492, datë 13.3.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit”.
- Ligji Nr .8778, datë 26.4.2001 “Për Ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin”.

D. Doktrinë

- Trajnim vazhdues Shkolla e Magjistratures, Dhimitër Lara & Sotir Kllapi, “Korrupsioni aktiv dhe pasiv i funksionarëve publikë dhe në sektorin privat” 02-03 Mars 2023;
- Ismet Elezi, “E drejta penale, pjesa e posaçme”, 2016.
- Phd (cand.) Fjorida Ballauri (Kallço), “Konflikti i interesit dhe veprat penale në fushën e prokurimeve publike”, JUS & JUSTICIA / NR.9 / VJESHTË 2014.
- <https://uet.edu.al/jus-justicia/wp-content/uploads/2023/01/Konflikti-i-interesit-dhe-veprat-penale-ne-fushen-e-prokurimeve-publike.pdf>

E. Jurisprudencë Kombëtare

- Vendimi Nr. 216, datë 16.12.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi Nr. 484, datë 19.05.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;
- Vendim Nr. 3 datë 02.11.2015, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

F. Jurisprudencë Ndërkombëtare

- [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57499%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57499%22]})
- Vendim i GjEDNj-së, Çështja Handyside v. United Kingdom (1976)
[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-57499%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-57499%22]})

ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE

**Rastet e korrupsionit të nivelit të lartë
në sektorin e shëndetësisë në Shqipëri
për periudhën 2014-2024**



Together for Life

Website: www.togetherforlife.org.al

Email: info@togetherforlife.org.al

Adresa: **Rr. Brigada VIII, Tiranë**